



ГОДИШНА ПРОГРАМА ЗА РАБОТА  
НА ФОНДОТ ЗА ИНОВАЦИИ И  
ТЕХНОЛОШКИ РАЗВОЈ  
ЗА 2023 ГОДИНА

PROGRAMI VJETOR I PUNËS  
SË FONDIT TË INOVACIONEVE  
DHE TË ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
PËR VITIN 2023

**PËRMBAJTJA**

<b>HYRJA</b> .....	5
<b>VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET AFATGJATA</b> .....	6
<b>GRUPI I SYNUAR</b> .....	7
<b>VEPRIMTARIA BAZË DHE DETYRAT</b> .....	7
<b>SHTYLLA 1 – MBËSHTETJA FINANCIARE E SEKTORIT PRIVAT</b> .....	9
- Mbështetja financiare e sektorit privat nëpërmjet Planit të rritjes ekonomike të Qeverisë së RMV-së, Shtylla 3 .....	9
- Mbështetja e vetëpunësimit nëpërmjet zhvillimit të bizneseve inovative "INGrupi" .....	13
- Përforcimi i kapaciteteve të Fondit nëpërmjet mbështetjes teknike nga Banka Botërore.....	13
- Zhvillimi i mekanizmave të reja dhe ekzistuese për mbështetje të sektorit privat.....	14
<b>SHTYLLA 2 - MBSËHTETJA E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT</b> .....	15
- Ndihma teknike e Aplikuesve dhe programi i mentorimit për përdoruesit.....	15
- Programi zhvillimor për mentorime të synuara.....	16
- Zbatimi i programeve të mentorimit në bashkëpunim me sektorin korporativ.....	16
- Programi për inovacion korporativ.....	16
- Strategjia nacionale për inteligjencë artificiale.....	17
- Partneriteti strategjik me Amazon Web Service.....	17
- Partneritete me banka.....	17
- Shtetësi ekonomike.....	18
- Partneritete.....	18
o Bashkëpunimi me partnerë vendor.....	19
o Bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë.....	21
o Partneritete tjera.....	24
o Sfida tematike.....	24
▪ Ekonomia e gjelbër.....	25
▪ Digjitalizimi i sektorit publik .....	25

▪	Startap habe dhe habe të inovacionit digjital (Digital Innovation Hub – DIH).....	26
▪	Zinxhiri i furnizimit/ Supply chain.....	26
▪	Teknologjia e shëndetësisë (Healthtech).....	26
▪	Teknologjia financiare (Fintech).....	27
	<b>SHTYLLA 3 - EKOSISTEM STARTAP.....</b>	<b>28</b>
	<b>SHTYLLA 4 – SISTEMI HELIKS TREFISH/KATËRFISH.....</b>	<b>30</b>
-	ARSIMI DHE TRAJNIMI.....	30
o	Sfida për kërkuesit e rinj.....	31
o	Mbështetja e programeve të suksesshme globale arsimore, që e nxisin mendimin kritik, inovacionin, kreativitetin dhe SHTIAM te nxënësit dhe të rinjtë.....	32
o	Mbështetja e posaçmërisë teknologjike dhe shkencore dhe sipërmarrësia te nxënësit dhe të rinjtë.....	32
o	Platforma e rrjetëzimit të mobilizimit dhe racionalizimit të burimeve.....	33
-	BASHKËPUNIMI NDËRMJET BASHKËSISË HULUMTUESE, SHKENCORE DHE AKADEMIKE DHE SEKTORIT PRIVAT .....	33
-	MBËSHTETJA FINANCIARE .....	34
o	Kuponë inovacioni.....	34
o	Grante bashkëpunuese.....	34
-	INFRASTRUKTURA E INOVACIONIT.....	35
o	Zyra nacionale e transferimit të teknologjive.....	35
o	Labororët e prodhimit të “FAB LABS”.....	35
o	Labororë të kërkimit, krijimit dhe inovacionit "MAKERSPACE".....	35
	<b>SHTYLLA 5 – IMPAKTI FIZHT.....</b>	<b>35</b>
-	Analiza e portofolit të përdoruesve të Fondit nga sektori privat.....	35
-	Analiza e performancave financiare të punës së përdoruesve të Fondit.....	36
-	MARKETING DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN.....	37
-	MONITORIMI DHE VLERËSIMI (monitorimi i përdoruesve).....	38
	<b>PUNËT E PËRGJITHSHME, JURIDIKE DHE FINANCA.....</b>	<b>38</b>
-	Menaxhimi.....	38
-	Struktura organizative.....	39
-	Procese të tjera.....	40
-	Dispozita përfundimtare.....	40

Bazuar në nenin 28, paragrafi 1 të Ligjit të Veprimtarisë Inovative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 79/13, 137/13, 41/14, 44/15, 6/16, 53/16, 190/16 dhe 64/18) dhe nenit 20 paragrafi 2 nënparagrafi 4 të Statutit të Fondit të Inovacioneve dhe të

Zhvillimit Teknologjik, Këshilli drejtues i Fondit, me propozim të drejtorit të Fondit, në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_2023, miratoi

**PROGRAM VJETOR TË PUNËS**  
**SË FONDIT TË INOVACIONEVE DHE TË ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK**  
**PËR VITIN 2023**

Programi i punës së Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme Fondi) për vitin 2023 është në funksion të realizimit të prioriteteve strategjike në pajtim me Programin afatmesëm të punës së Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik për periudhën 2021–2023.

Programi i punës mbulon periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2023.

Vlera totale: **1,191,345,133,00** (një miliard, njëqind e nëntëdhjetë e një milion, treqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e tridhjetë e tre) denarë.

**HYRJE**

Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik është person juridik i themeluar në pajtim me Ligjin e Veprimtarisë Inovative, i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së

Maqedonisë së Veriut, me numër vendimi 30120130043573, datë 16.12.2013 dhe numrin amzë 6920098.

Fondi synon të promovojë dhe inkurajojë aktivitetin inovativ, përmirësimin e qasjes në shërbimet financiare për inovacion, zhvillimin e infrastrukturës së inovacionit dhe zhvillimit teknologjik, dhe zhvillimin e partneriteteve. Synimi kryesor është nxitja e zbatimit të inovacioneve tek kompanitë vendore, duke siguruar burime shtesë për financimin e inovacioneve, si bazë për ndërtimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri.

Ne e arrijmë këtë qëllim duke mbështetur krijimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore, duke mbështetur miratimin e legjislacionit përkatës dhe proceseve të tjera të rëndësishme shoqërore, që kanë ndikim në faktorët inkurajues për pozicionimin e suksesshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke ofruar grante të bashkëfinancuara për inovacione dhe zhvillime teknologjike, ndihmë teknike për kompanitë, për të lehtësuar qasjen në fondet rajonale, investimet aksionare dhe mezanin dhe ndihma financiare për hulumtime.

Sipas përcaktimeve të tij programore dhe politikës zhvillimore, Fondi mund të marrë pjesë në bashkëfinancimin e programeve dhe aktiviteteve të tjera, nëse ato organizohen dhe financohen nga organizata ndërkombëtare, institucione dhe organe financiare dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë të huaj dhe vendor.

Me zbatimin e synimeve të përcaktuara, ne kontribuojmë në mënyrë aktive në zhvillimin e përshpejtuar teknologjik bazuar në transferimin e njohurive, kërkimeve zhvillimore dhe inovacionin që kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, por edhe në përmirësimin e klimës së biznesit për zhvillimin e aftësisë konkurruese të sipërmarrjeve.

## **VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET AFATGJATA**

Vizioni - i Fondit të Inovacionit dhe të Zhvillimit Teknologjik është të jetë një institucion qendror për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik duke inkurajuar inovacionin dhe zhvillimin teknologjik. Për realizimin e këtij vizioni, Fondi do të zbatojë disa iniciativa të reja në zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve financiare dhe jofinanciare, për ndërmarrjet me edukim sistematik dhe modern, dhe mbështetje të të gjithë aktorëve relevantë në shoqëri.

Misioni i Fondit është të inkurajojë dhe mbështesë aktivitetin inovativ në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, me qëllim arritjen e zhvillimit të përshpejtuar teknologjik, të bazuar në transferimin e njohurive, kërkimin për zhvillim dhe inovacionet që kontribuojnë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe për rritje ekonomike dhe zhvillim, duke përmirësuar njëkohësisht mjedisin e biznesit për zhvillimin e aftësive konkurruese të kompanive.

Prioritetet dhe synimet:

- Qasje të përmirësuar në shërbimet financiare për inovacione dhe zhvillim teknologjik,
- Promovimin dhe inkurajimin e veprimtarisë së inovacionit,
- Forcimi i infrastrukturës së inovacionit në drejtim të lidhjes së institucioneve publike, komunitetit akademik dhe shkencor, industrisë dhe qytetarëve,
- Sigurimi i qëndrueshmërisë së masave të suksesshme për të mbështetur aktivitetin e inovacionit,
- Prezantimi i masave të reja për të mbështetur aktivitetin e inovacionit në drejtim të tejkalimit të dobësive në ekosistemin nacional të inovacionit.

Qëllimi i Fondit është të inkurajojë inovacionin duke ofruar burime shtesë financimi, si një kontribut në ndërtimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri.

Qëllimet e përcaktuara zbatohen nëpërmjet instrumenteve ekzistuese dhe masave mbështetëse, dhe punojmë në zhvillimin e masave të reja për të mbështetur inovacionin dhe zhvillimin teknologjik.

Aktivitetet tona përfshijnë:

- Bashkëfinancimin e startapeve, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Këshillin Nacional të Startapit, i cili përgatiti dokumentin e parë me masat e propozuara për ndryshime ligjore dhe qëllimi i të cilit është transformimi i startap ekosistemit të Maqedonisë;
- Programin për inovacion korporativ, me qëllim të inkurajimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe startapeve;
- Partneriteti me Amazon Web Services nëpërmjet të cilit Fondi siguron kredi për përdorimin e kësaj platforme globale në shumën 10,000, 25,000 dhe 100,000 dollarë amerikan;
- Portofoli i veçantë për investime në digjitalizimin e bujqësisë dhe të institucioneve publike;
- Zhvillimi i një Strategjie Nacionale për Inteligjencën Artificiale;

- Mbështetje mentoruese për përdoruesit e mundshëm dhe aktualë.

Fondi mbështet gjithashtu nxënës të talentuar të shkollave fillore, gjimnazistë dhe studentë

- Në kuadër të katër sfidave “Sfida për hulumtuesit e rinj”, u shpërblyen 109 projekte shkollore, në të cilat marrin pjesë mbi 728 nxënës dhe mentorë nga i gjithë vendi. Për herë të parë zhvilluam edhe një Sfidë për krijimin e laboratorëve të prodhimit "Të rinjtë krijojnë". Nëpërmjet mbështetjes së "Junior Achievement Macedonia" dhe programit për edukimin ndërmarrës në të gjitha shkollat e mesme anembanë vendit, kemi përkrahur 728 nxënës dhe 100 mësues. Në kuadër të programit "UpShift", Fondi shpërbleu 32 idetë më të suksesshme.

### GRUPI I SYNUAR

- Përdoruesit e drejtpërdrejtë:
  - Sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
  - Institucionet arsimore, të arsimit sipëror dhe shkencore
  - Shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet
  - Persona të tjerë juridikë dhe fizikë të përcaktuar në dispozitat e akteve nënligjore përkatëse
- Përdoruesit indirekt:
  - Institucionet publike
  - Sipërmarrjet e mëdha
  - Të gjithë pjesëmarrësit në procesin arsimor (nxënës, studentë, mësues, prindër, personel akademik, etj.)
  - Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut

### **VEPRIMTARIA BAZË DHE DETYRAT**



Aktiviteti kryesor i Fondit është ofrimi i mbështetjes financiare për sipërmarrjet e regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të nxitjes së aktivitetit inovativ nëpërmjet granteve të bashkëfinancuara që ndahen në baza konkurruese.

Detyrat themelore të Fondit janë si më poshtë:

- financimi, përgatitja, realizimi dhe zhvillimi i programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera në fushën e zbatimit të politikës së inovacionit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- punët profesionale dhe të tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e mjeteve në Fondin, menaxhimin e atyre fondeve dhe përdorimin e tyre;
- ndërmjetësimi në financimin e veprimtarisë së inovacionit nga mjetet e organizatave ndërkombëtare, institucioneve dhe organeve financiare, si dhe personave juridikë e fizikë vendor dhe të huaj, veçanërisht në fushën e shkencës dhe teknologjisë, sipas prioriteteve të përcaktuara në strategjinë e inovacionit;
- mbajtjen e një baze të dhënash për përdoruesit e mjeteve të akorduara nga Fondi, të dhëna identifikuese për subjektet të cilave u janë miratuar mjetet, programet, projektet dhe aktivitetet e tjera në fushën e veprimtarisë së inovacionit të financuar nga Fondi, si dhe të dhënat e nevojshme dhe mjetet financiare në dispozicion për realizimin e tyre;
- nxitjen dhe hyrjen në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare dhe vendore, por edhe me persona të tjerë juridikë dhe fizikë, për shkak të financimit të veprimtarisë së inovacionit, në pajtim me politikën e inovacionit, planet dhe programet e tjera strategjike, si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- pjesëmarrje në formimin e Zyrës Nacionale për Transferimin e Teknologjive, për mbështetje dhe inkurajim të bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe industrisë;
- pjesëmarrja në ngritjen e një Parku të Shkencës dhe Teknologjisë, me qëllim mbështetjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe sektorit privat;
- përzgjedhja e një shoqërie për administrimin e fondeve private nëpërmjet thirrjes publike, e cila do të administrojë me mjetet e Fondit të destinuara për realizimin e instrumenteve të investimeve aksionare dhe mezanin;
- themelimin e një Fondi i Investimeve Aksionare dhe Mezanin, dhe miratimin e një statuti dhe prospekti të Fondi i Investimeve Aksionare dhe Mezanin, dhe
- monitorimin dhe vlerësimin e projekteve për të cilat janë ndarë mjete, me qëllim të zhvillimit të shoqërisë sipërmarrëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Fondi përmbush detyrat e tij duke ndarë burime financiare për:

- sigurimin e shërbimeve dhe kapitalit fillestar për themelimin dhe rritjen e shoqërive tregtare nëpërmjet dhënies së mjeteve financiare për projekte të inovacionit;
- dhënien e granteve të bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve, zhvillimin teknologjik, kupona të inovacionit;
- nxitjen e investimeve private dhe financimi i projekteve të zhvillimit dhe/ose inovacionit në të gjitha fazat e zhvillimit nëpërmjet kapitalit të vet, dhe nëpërmjet kombinimit të

- kapitalit pronësor dhe kredive, nëpërmjet sigurimit të burimeve të favorshme të kredive dhe garancive për investitorët,
- mbështetjen për krijimin e fondeve private duke investuar mjete ose duke garantuar fitimin nga mjetet e investuara; dhe
  - inkurajimin e inovacionit në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë në pajtim me strategjinë e inovacionit.

## **SHTYLLA 1 - MBËSHTETJA FINANCIARE E SEKTORIT PRIVAT**

- Mbështetje financiare për sektorin privat nëpërmjet Planit të rritjes ekonomike të Qeverisë së RMV-së, Shtylla III

Fondi, si bartës i shtyllës së tretë të Planit të rritjes ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (në tekstin e mëtejshëm: NMVM-të), në koordinim me Zyrën e kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kabinetit të zëvendëskryetarit të Qeverisë, përgjegjës për punët ekonomike dhe koordinimin me departamentet ekonomike, do të vazhdojnë të punojnë në aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e shtyllës 3 të Planit të rritjes ekonomike. Bëhet fjalë për masa për nxitjen e investimeve, eksportit dhe konkurrencës së ekonomisë së Maqedonisë, përkatësisht:

(a) Masa 1: Mbështetja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) me tendencë rritjeje të shpejtë (“Gazelat”);

Mbështetja ofrohet për aktivitetet dhe kostot e mëposhtme të investimeve:

- pranimi dhe zbatimi i rregulloreve teknike europiane në lidhje me sigurinë e produkteve;
- përgatitjet për marrjen e certifikatave të cilësisë;
- aktivitetet për analizën, përgatitjen, përvetësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale;
- përgatitja dhe zbatimi i aktiviteteve për përmirësimin e efikasitetit energjetik;
- përgatitja e elaborateve për mbrojtjen e mjedisit;
- përgatitja dhe ngritja e sistemeve të menaxhimit të mbeturinave;
- futja e sistemeve të informacionit;
- kostot për mbështetje teknike (ekspertizë), bazuar në një profil të dorëzuar më parë të ekspertëve vendor dhe/ose të jashtëm që do të angazhohen në projekt;
- kostot që lidhen me procedurat para organizatave, instituteve kërkimore-shkencore, kompanive dhe organizatave ndërkombëtare që lidhen me blerjen e certifikatave të cilësisë, blerjen e patentave dhe të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale, si dhe dokumente të tjera që lidhen me veprimtari investimi, të cilat lëshohen nga një subjekt i certifikuar;
- kostot për shërbimet kontraktuale për kërkim dhe zhvillim (p.sh. testimi, shërbimet laboratorike, etj.);

- kostot për blerjen ose marrjen me qira të pajisjeve, mjeteve të TI-së dhe llojeve të tjera të mjeteve bazë për NMVM-të, të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e Projektit të zhvillimit teknologjik;
- kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit, përveç pagave dhe prokurimet nga ndërmarrjet publike vendore.

Aplikuesi mund të përdorë mbështetjen financiare për një periudhë deri në 18 muaj nga data e miratimit të projektit.

(b) Masa 2: Mbështetje e veçantë (shitesë) financiare për NMVM-të;

Mbështetja ofrohet për aktivitetet dhe kostot e mëposhtme të investimeve:

- mbështetje teknike nga ekspertë të jashtëm për përgatitjen e planeve strategjike afatmesme dhe afatgjata;
- trajnime për planifikimin afatmesëm të biznesit (plani i biznesit trevjeçar);
- përgatitja e projekteve zhvillimore për lidhje afariste dhe vendosja e bashkëpunimit afarist (në një periudhë prej 3 deri në 5 vjet) me investitorët e huaj dhe me ndërmarrjet vendase;
- përmirësimi i strukturës organizative për të përballuar rritjen e kompanisë;
- **trajnim i specializuar për menaxhimin dhe trajnime për shitje - programe për zhvillimin e aftësive të ekipeve të menaxhimit dhe shitjes;**
- trajnimi për njohjen e talenteve (liderët e ardhshëm) dhe krijimi i programeve të zhvillimit të talenteve (liderët e ardhshëm);
- trajnime për planifikimin dhe kontrollin e kostove;
- prokurimi ose zhvillimi i softuerit specifik në lidhje me përmirësimin e strukturës dhe performancës organizative, ose përmirësimin e proceseve operative që do të rrisin produktivitetin dhe/ose procesin e planifikimit;
- kostot për mbështetje teknike (ekspertizë), bazuar në një profil të dorëzuar më parë të ekspertëve vendor dhe/ose të jashtëm që do të angazhohen në projekt;
- kostot lidhur me përgatitjen dhe realizimin e trajnimeve;
- kosto të tjera që lidhen me zbatimin e një plani për përmirësimin e strukturës organizative të kërkuesit;
- kostot për prokurimin dhe/ose zhvillimin e pajisjeve, softuerëve, mjeteve të TI-së dhe llojeve të tjera të burimeve bazë të TIK-ut për NMVM-të që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e Projektit të zhvillimit teknologjik;
- kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit, përveç pagave dhe prokurimet nga ndërmarrjet publike vendore.

Aplikuesi mund të përdorë mbështetjen financiare për një periudhë deri në 18 muaj nga data e miratimit të projektit.

(c) Masa 3: Mbështetje financiare për përmirësimin e inovacionit;

Mbështetja ofrohet për aktivitetet dhe kostot e mëposhtme të investimeve:

- përpunimi i aspekteve tekniko-teknologjike në zhvillimin dhe prezantimin e produkteve apo shërbimeve të reja;
- të përmirësojë ndjeshëm produktet ose shërbimet ekzistuese;
- krijimi i koleksioneve të reja të modës;
- prodhimi i dizajnit industrial ose ridizajnimi i produkteve;
- përpunimi i ambalazheve të reja;
- përpunimi i planeve të marketingut (analiza e tregut, analiza e konkurrencës, hulumtimi i produktit, shitjet, etj.);;
- përmirësimi i procesit ekzistues ose futja e një procesi të ri prodhimi;
- pagat bruto (për personat e punësuar të përdoruesi dhe anëtarët e konsorciumit) shuma e të cilave duhet të korrespondojë me praktikatat e vendosura të përfituesit përpara fillimit të projektit;
- prokurimi dhe/ose dhënia me qira e pajisjeve dhe materialeve harxhuese për kërkime dhe zhvillim;
- shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit të nënkontraktuara (p.sh. testimi, shërbimet laboratorike, etj.);
- angazhimi i ekspertëve/këshilltarëve për kërkime dhe zhvillim;
- punësimi i konsulentëve për nevoja të tjera që lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme të projektit (ekspertiza në lidhje me menaxhimin e inovacionit, menaxhimin financiar, mobilizimin e mjeteve, zhvillimin e biznesit, shitjet, marketingun, punët ligjore, mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe të tjera);
- përgatitja dhe dorëzimi i kërkesës për patentë, mbrojtje të markës tregtare dhe/ose dizajnit industrial dhe aktiviteteve të tjera përgatitore për regjistrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale;
- kostot për marketing dhe mbështetje të zyrës dhe afariste në një shumë maksimale prej 10% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

Aplikuesi mund të përdorë mbështetjen financiare për një periudhë deri në 24 muaj nga data e miratimit të projektit.

(d) Masa 4: Mbështetje financiare për përmirësimin profesional dhe praktik për të rinjtë e sapopunësuar

Mbështetja nga kjo masë jepet për përmirësimin profesional dhe/ose praktikë për personat deri në moshën 29 vjeç, të punësuar nga kërkuesi për të paktën 6 muaj para dorëzimit të kërkesës për mbështetje financiare. Mbështetja përfshin mbulimin e:

- kostove për trajnimin profesional dhe praktikën për një të ri të sapopunësuar të kërkuesit (përfshirë Fast Track Management Programme);
- kostot për trajnimin dhe praktikën profesionale për një të ri të sapopunësuar në një kompani dhe/ose organizatë tjetër që ofron këtë lloj shërbimi;

- kostot që lidhen me përgatitjen dhe zbatimin e një plani për forcimin e aftësive profesionale dhe teknike;
- shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit brenda dhe jashtë vendit, nëse programi për përmirësim profesional dhe/ose praktikë zbatohet jashtë vendbanimit të punonjësit;
- kostot për aplikim, kuotizim dhe kompensimet e tjera për pjesëmarrje në programin për përmirësim profesional dhe/ose praktikë të arkëtuara nga organizatori (një subjekt i ndryshëm nga kërkuesi);
- shpenzimet për përgatitjen dhe dhënien e provimeve, për marrjen e certifikatave dhe dokumenteve të tjera për një program dhe/ose praktikë të zbatuar me sukses;
- kosto të tjera direkte që lidhen me organizimin dhe/ose pjesëmarrjen në program për përmirësim profesional dhe/ose praktikë.

Mbështetja e përgjithshme sipas kësaj mase për një kërkues mund të përdoret për një periudhë deri në 24 muaj, për një të ri të sapopunësuar.

(e) Masa 5: Krijimi i një mjedisi dhe hartimi i bazave ligjore për zhvillimin e kapitalit të rrezikut dhe "Engjëjve të Biznesit"

Mjetet nga kjo masë mund të shfrytëzohen edhe nëpërmjet Fondit të Investimeve Aksionare dhe Mezanin të krijuar nga Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik, me pjesëmarrje deri në 25% të vlerës së investimit nga fondet e veta të kërkuesit, por jo më shumë se 30.000.000 denarë. Mbështetja nëpërmjet Fondit të Investimeve Aksionare dhe Mezanin do të zbatohet nëpërmjet aplikimit dhe vlerësimit gjatë gjithë vitit.

Mbështetja nga kjo masë jepet për përgatitjen dhe realizimin e projekteve të zhvillimit teknologjik të kërkuesit, dhe i mbulon të gjitha kostot e pranueshme për financim sipas masave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij programi.

Kërkuesi mund të përdorë mbështetjen financiare për një periudhë deri në 36 muaj nga dita e miratimit të projektit, me mundësi vazhdimi për maksimum 24 muaj.

Kjo masë nuk ndikon në kushtet për përdorimin e mjeteve, që Fondi i Investimeve Aksionare dhe Mezanin i siguron nga burime të tjera financimi.

Masat nga Plani i Rritjes Ekonomike, Shtylla 3, mund t'i nënshtrohen ndryshimeve të kushteve, sipas propozimeve dhe rekomandimeve të dala nga konsultimet me përdoruesit e mundshëm. Masat nga Plani i Rritjes Ekonomike, Shtylla 3 zbatohen nëpërmjet instrumenteve mbështetëse të mëposhtme:

- ✓ Grante të bashkëfinancuara për zhvillim teknologjik;
- ✓ Grante të bashkëfinancuara për të përmirësuar inovacionin
- ✓ Grante të bashkëfinancuara për përmirësimin profesional dhe praktikën e të rinjve të sapopunësuar
- ✓ Grante të bashkëfinancuara për zhvillimin teknologjik për tejkalimin e pasojave të krizës së COVID-19

- ✓ Grante të bashkëfinancuara për zhvillim teknologjik për rritje të përsheptuar ekonomike

Kushtet e përdorimit, kriteret e përshtatshmërisë së aplikuesve, qëllimi i instrumentit mbështetës, shumat e mbështetjes, kushtet për bashkëfinancim, si dhe kushtet e tjera për secilin instrument të veçantë janë parashikuar në Rregulloren për instrumentin, dhe ato mund të jetë subjekt i ndryshimeve në varësi të propozimeve dhe rekomandimeve të marra nga sektori privat, si dhe nga faktorë të tjerë dhe partnerë institucionalë të Fondit.

**Si rezultat i Projektit të zhvillimit të aftësive dhe mbështetjes së inovacionit, të financuar nëpërmjet një kredie nga Banka Botërore, Fondi zhvillon dhe siguron mbështetje financiare nëpërmjet 4 (katër) instrumenteve të mbështetjes së sektorit privat:**

- 1) grante të bashkëfinancuara për shoqëritë tregtare start-up dhe spin-of;
- 2) grante të bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve;
- 3) grante të bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e përsheptuesve teknologjik-afarist
- 4) grante të bashkëfinancuara për zgjerimin e teknologjisë.

Kushtet e përdorimit, kriteret e përshtatshmërisë së aplikuesve, qëllimi i instrumentit mbështetës, shumat e mbështetjes, kushtet për bashkëfinancim, si dhe kushtet e tjera për secilin instrument të veçantë janë parashikuar në Rregulloren për instrumentin, dhe ato mund të jetë subjekt i ndryshimeve në varësi të propozimeve dhe rekomandimeve të marra nga sektori privat, si dhe nga faktorë të tjerë dhe partnerë institucionalë të Fondit.

**Duke pasur parasysh se “Projekti për zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e inovacionit” i financuar nëpërmjet një kredie nga Banka Botërore u përfundua me sukses më 30 prill 2021, instrumentet e mbështetjes të zhvilluara nëpërmjet projektit financohen nëpërmjet buxhetit të Fondit.**

**Gjatë vitit 2023, Fondi planifikon të publikojë thirrjet publike për instrumentet e mëposhtme:**

Nr.	Muaj	Tremujori:	Instrumenti	Buxheti i planifikuar (EUR)	Afati i aplikimit	Publikimi i rezultateve	Numri i pritshëm i aplikacioneve të mbështetura
1	mars	I	Grante të bashkëfinancuara për Zhvillim	5,060,000	45	Qershor 2023	120

			Teknologjik për Rritje Ekonomike të Përsheptuar				
2	Maj	II	Grante të bashkëfinancuara për shoqëritë tregtare start-up dhe spin-of të formuar rishtas;	2,000,000	45	Korrik 2023	75
3	III	Grante të bashkëfinancuara për komercia lizimin e inovacioneve;	8,000,000	45	Dhjetor 2023	45	III
4	Nëntor	IV	Grantet e bashkëfinancuara për përsheptuesit e biznesit	1,200,000	45	Janar 2024	5
GJITHSEJ				<b>16,260,000</b>			<b>245</b>

- **Mbështetja e vetëpunësimit nëpërmjet zhvillimit të biznesit inovativ "INgrupi"**

Iniciativa zbatohet nëpërmjet Programit të vetëpunësimit në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Agjencinë e Punësimit, për të mbështetur personat e papunë për të filluar biznesin e tyre. Fondi është i përfshirë në pjesën e identifikimit të ideve të biznesit me potencial për rritje të shpejtë, të ashtuquajturat "InGrupa", të cilit i ofrojmë mbështetje mentoruese pas regjistrimit të sipërmarrjes. Qëllimi është forcimi i kapaciteteve dhe paraqitja e këtyre kompanive në thirrjet e Fondit për dhënien e mbështetjes financiare.

- **Forcimi i kapaciteteve të Fondit nëpërmjet mbështetjes teknike nga Banka Botërore**

Fondi është përdorues i asistencës teknike "Innovation and Competitiveness Ecosystem TA", financiar nga fondi britanik "Good Governance and Investment Climate Reform- (GGICR)", dhe e njëjta sigurohet nga Banka Botërore. Qëllimi i asistencës teknike është identifikimi i aktiviteteve, me të cilat ekosistemi për inovacion dhe konkurrencë në nivel të sektorit privat do të jetë më efikas dhe konkurrues. Qëllimi i mbështetjes është të përfitojë ekonomia e Maqedonisë së Veriut, duke përmirësuar aftësitë inovative të kompanive, të cilat do të kontribuojnë në forcimin e rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

Ky synim më i gjerë do të arrihet nëpërmjet disa kanaleve:

1. Analiza e nevojshme për të parë se si të përmirësohen instrumentet e inovacionit dhe mbështetja institucionale (komponenti 1);

2. Përshtatja në hartimin e instrumenteve të inovacionit për t'u fokusuar në market failures dhe nevojat kritike të kompanive (komponenti 2):
3. Përmirësime në strukturat institucionale, kornizat ligjore dhe kapacitetet e institucioneve qeveritare, që i zbatojnë instrumentet mbështetëse (komponenti 2);
4. Përmirësimet në kornizën ligjore për kapitalin e rrezikshëm (Komponenti 3) dhe
5. Zhvillimi i një pipeline më të fortë kompanish, që kanë kapacitet për inovacione, dhe mund të përfitojnë nga instrumentet, transparencë më të madhe, qasje në informacion dhe angazhim qytetar (komponenti 4).

Si rezultat i asistencës teknike, Fondi, në bashkëpunim me Bankën Botërore, do të vazhdojë aktivitetet e tij për të krijuar një fond hibrid investimesh për të mbështetur ndërmarrjet startup dhe ndërmarrjet inovative mikro, të vogla dhe të mesme, me menaxhimin e fondit të investimeve nga një kompani private e menaxhimit të fondeve. Objektivi kryesor i këtij fondi do të jetë zhvillimi i tregut të kapitalit dhe lehtësimi i qasjes në financa për kompanitë fillestare, si dhe zhvillimi i financimit të kapitalit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Aktivitetet e fondit janë planifikuar të vazhdojnë deri në vitin 2023. Fondi fillimisht do të fillojë me aktivitetet e financimit të kompanive startup nga Republika e Maqedonisë së Veriut, por në një fazë të mëtejshme, do të merren parasysh edhe kushtet dhe mundësitë për zgjerimin e fushëveprimit të financimit të kompanive fillestare nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

- **Zhvillimi dhe përmirësimi i mekanizmave ekzistues të mbështetjes së sektorit privat**

Përveç llojeve të mbështetjes tashmë të zhvilluara, Fondi do të punojë në vitin 2023 për të siguruar mbështetje shtesë për zhvillimin e segmenteve të mëposhtme:

- Zhvillimi i financimit të kapitalit aksionar, pra krijimi i kushteve për zhvillimin e kapitalit sipërmarrës nëpërmjet krijimit të një fondi hibrid investimesh për financimin në ndërmarrjet startup, por edhe në ndërmarrjet inovative mikro, të vogla dhe të mesme, ku menaxhimi i Fondit do të bëhet nga një shoqëri private e menaxhimit të fondeve;
- Zhvillimi dhe mbështetja e startapeve dhe kompanive inovative që punojnë në zhvillimin e teknologjive të reja të avancuara (Deep Tech) – Fondi do të zhvillojë një mekanizëm për të kanalizuar fonde dhe aktivitete, në mënyrë që të sigurojë mbështetje më të madhe për ndërmarrjet që punojnë në zhvillimin e zgjidhjeve duke përdorur teknologji të përparuara si inteligjenca artificiale, robotika, blokçein (blockchain), materiale të përparuara dhe prodhim, fotonikë dhe elektronikë, bioteknologji, etj.
- Zhvillimi dhe mbështetja e ekonomisë së gjelbër nëpërmjet financimit të aktiviteteve “Green deal” nga sektori privat;
- Zhvillimi dhe mbështetja e sipërmarrësisë sociale (ndikimi) – si rezultat i përgjigjes ndaj sfidës së sipërmarrësisë sociale gjatë vitit 2021, dhe nivelit të interesit që u krijua brenda këtij sektori, Fondi do të zhvillojë një mekanizëm për të drejtuar financimin dhe aktivitetet në mënyrë që të sigurojë mbështetje më të madhe për ndërmarrjet që punojnë



drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të KB-ve (SDGs) ose bizneseve me ndikim;

- Zhvillimi dhe mbështetja e programeve për të përmirësuar gatishmërinë e investimeve të startapeve dhe kompanive inovative, dhe qasjen në tregje me opsinin e bashkëfinancimit të investimeve (1:1) – Bazuar në reagimet nga funksionimi i përshpejtuesve dhe sfidat e tyre në gjetjen e startapeve me cilësi të lartë për investime, Fondi do të zhvillojë një mekanizëm për të kanalizuar fonde dhe aktivitete për të mbështetur zhvillimin dhe zbatimin e programeve për të përmirësuar gatishmërinë e investimeve të startapeve dhe kompanive inovative (Investment Readiness) dhe programet për përmirësimin e qasjes në tregje (Access to Markets). Financimi i startapeve që do të kalojnë nëpërmjet programeve të tilla do të varet vetëm nga fakti, nëse zbatuesi i programit apo vetë startapi do të jetë në gjendje të tërheqë fonde nga investitorë privatë nga vendi dhe nga jashtë, me ç'rast Fondi do të shfaqet si bashkë-investitor dhe për çdo 1 euro të investuar do të japë 1 euro në formën e grantit.
- Komercializimi i inovacioneve në teknologjinë bujqësore – Në kuadër të instrumentit Grantet e bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve, një pjesë e burimeve financiare do të ndahen për të mbështetur aktivitetet në fushën e teknologjisë bujqësore ose agroteknologjisë, aplikimin e praktikave inovative në prodhimin primar bujqësor, përpunimin e produkteve bujqësore, përmirësimin e zinxhirëve të furnizimit, aplikimin e arritjeve shkencore dhe kërkimore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe në përgjithësi zbatimin e praktikave inovative në zonat rurale.

## SHTYLLA 2 - MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT

- **Asistencë teknike për aplikuesit dhe program mentorimi për përdoruesit:**

Në kuadër të aktiviteteve tona, ne do të vazhdojmë të ofrojmë asistencë teknike dhe mbështetje për sektorin privat në fushën e shërbimeve të mentorimit, me qëllim ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të sektorit privat. Mbështetja përbëhet nga dy pjesë:

### ✓ **Asistencë teknike për aplikuesit**

Asistenca teknike për aplikuesit ofrohet gjatë fazës së aplikimit, gjatë së cilës sigurohen shërbime konsultimi për tema specifike që përcaktohen sipas karakteristikave të instrumentit mbështetës, për të cilin është publikuar një thirrje.

### ✓ **Mbështetje mentoruese për përdoruesit e mjeteve**

Pas nënshkrimit të marrëveshjes për mbështetje financiare me Fondin, dhe pas fillimit të zbatimit të projektit, nëpërmjet takimeve individuale konsultative, nevojat e secilit përdorues vlerësohen veçmas dhe sipas të njëjtit diagnostikim, përcaktohen fushat e trajnimit. Lista e fushave për mentorim nuk është e kufizuar, sepse ato zhvillohen sipas nevojave të kompanive dhe sipas praktikave të përcaktuara ndërkombëtarisht, si dhe kushteve ekzistuese të tregut.

Mbështetja e mentorimit është planifikuar të kryhet gjatë vitit 2023 nëpërmjet mentorimit individual dhe trajnimit në grup. Për këtë qëllim, FIZHT do të punësojë shtëpi konsulente dhe konsulent nga vendi dhe jashtë vendit, të cilët do të zbatojnë mentorimin dhe trajnimin.

- **Zhvillimi i një programi për mentorime "të orientuara":**

Për të siguruar një nivel më të lartë të cilësisë së mbështetjes teknike të ofruar tashmë nga Fondi për përdoruesit e tij ekzistues dhe potencialë, fushëveprimi i programit ekzistues të mentorimit do të rritet gjithashtu në të ardhmen duke prezantuar mbështetje për:

- ✓ aplikuesit e refuzuar – ata që kanë aplikuar për ndonjë nga instrumentet e Fondit, por propozimprojektet nuk janë miratuar për financim, me qëllim të përgatitjes së tyre më të mirë për ndonjë thirrje të mëvonshme ose lloj tjetër instrumenti në të ardhmen, dhe
- ✓ përdorues me rritje të shpejtë (scaleups) – një grup kompanish nga portofoli i përfituesve të mbështetjes së Fondit, të cilat do të identifikohen si me rritje të shpejtë me një potencial të provuar për zgjerim në tregjet e huaja – në mënyrë që të lehtësojnë dhe përshpejtojnë qasjen e tyre në treg jashtë vendit nëpërmjet trajnimeve dhe ushtrimeve të përshtatura për nevojat e tyre.

- **Zbatimi i programeve të mentorimit në bashkëpunim me sektorin e korporatave**

Duke ndjekur shembullin e bashkëpunimit me PricewaterhouseCoopers (PwC), me të cilin Fondi zbatoi programin e mentorimit The Catalyst, qëllimi kryesor i të cilit ishte forcimi i kapaciteteve të startapeve në tema dhe fusha të rëndësishme për operacionet e përditshme, përvetësimi i njohurive dhe aftësive të reja, si dhe lehtësimi i qasjes ndaj investitorëve potencialë, Fondi do të vazhdojë të ndërtojë partneritete strategjike me sektorin e korporatave në mënyrë që të përmirësojë gatishmërinë e kompanive për të hyrë në korporata, investitorë potencialë, si dhe sigurimin e qasjes më të lehtë në tregjet e reja.

- ✓ **Programi i inovacionit të korporatave**

Fondi do të vazhdojë të bashkëpunojë me përfaqësuesit e sektorit të korporatave dhe të sigurojë mbështetje për startapet nëpërmjet Programit të inovacionit të korporatave, duke mundësuar zhvillimin e modeleve të bashkëpunimit të kompanive të mëdha me startapet dhe kompanitë e reja inovative që zhvillojnë zgjidhje inovative në sektorë të ndryshëm në varësi të nevojave të sektorit të korporatave, dhe propozimeve të marra për bashkëpunim me Fondin. Fondi do të vazhdojë të ndërmjetësojë procesin e lidhjes së kompanive tashmë të themeluara në industri me kompani të reja, që përpiqen të depërtojnë në të njëjtat tregje me zgjidhjet e tyre inovative.

- ✓ **Strategjia Nacionale për Inteligjencën Artificiale**

Bazuar në pikën A 96 të Ekstraktit nga Projekt Procesverbali i seancës së gjashtëdhjetë e gjashtë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 20 prill 2021 me nr. 40-17/66, ushtruesi i detyrës drejtor i Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik më 24.09.2021, miratoi Vendimin për krijimin e Grupit të punës për përgatitjen e Strategjisë Nacionale për Inteligjencën Artificiale.

Grupi i punës, i përbërë nga përfaqësues nga sektori publik, privat, akademik dhe joqeveritar, mbajti takimin e parë dhe filloi punën, ndërsa Fondi zhvilloi një sërë takimesh me partnerët e

mundshëm strategjikë, donatorët dhe programet e donatorëve, të cilat pritet të kontribuojnë në zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë. Fondi do të vazhdojë të punojë drejt zhvillimit të strategjisë dhe pritet të ketë draft versionin e tij gjatë vitit 2023.

FIZHT do të bashkëpunojë me partnerët e saj nga organizatat ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe Programi Zvicëran për Rritjen e Punësimit të Tregut në mënyrë që të përgatisë një Plan veprimi për aktivitetet që do t'i paraprijnë Strategjisë së Inteligjencës Artificiale.

✓ **Strategjia Nacionale për “Specializimin FAB”**

**Në vitin 2023, FIZHT, në bashkëpunim me institucionet kompetente, do të intensifikojë miratimin e Strategjisë së "Specializimit të Zgjuar", e cila do të përcaktojë qëllimet dhe do të sigurojë kushte sistematike për krijimin, zhvillimin dhe zbatimin e inovacioneve.**

✓ **Partneritet strategjik me Amazon Web Services**

Në vitin 2021, Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik u bë partneri i parë strategjik i Amazon Web Services (AWS) për Maqedoninë e Veriut. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi me platformën globale klaud (cloud), përdoruesit e FIZHT, veçanërisht startapet në vend, kanë një sërë përfitimesh, duke përfshirë kreditë për përdorimin e infrastrukturës së platformës klaud në shumën prej: 10,000, 25,000 dhe 100,000 dollarëve amerikanë.

Partneriteti me Amazon Web Services siguron startapet me mbështetje teknike në zhvillimin e produkteve të tyre, si dhe qasje në shumë përmbajtje arsimore në internet, që AWS i siguron nëpërmjet partnerëve të tyre.

Në vitin 2022, ne vazhdojmë me bashkëpunim intensiv, me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe mjeteve të reja shtesë për startapet që shprehin interes për përdorimin e fondeve.

✓ **Partneriteti me bankat**

Në vitin 2021, FIZHT nënshkroi memorandume me 7 banka në vend, të cilat ofrojnë kushte më të mira huadhënieje për startapet. Fondi do të vazhdojë të krijojë bashkëpunime të reja dhe të nënshkruajë memorandume të tilla me bankat e reja në vitin 2023, në mënyrë që të lehtësojë qasjen në financim për kompanitë startap, por edhe për të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

✓ **Shtetësia Ekonomike**

**Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik, është paraparë si autoritet kompetent në procedurën për përcaktimin e ekzistencës së interesit të veçantë ekonomik në pajtim me Dekretin për përcaktimin e kritereve për interes të veçantë shkencor, ekonomik, kulturor, sportiv ose interes tjetër nacional në fitimin e shtetësisë së Republikës së**

Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 9/2005; nr. 161/2012; nr. 255/2019 dhe nr.42/2021).

Shtetësia ekonomike tërheq dhe lejon shtetësinë e investitorëve dhe sipërmarrësve me përvojë dhe të arsimuar, dhe qëllimi kryesor i këtij dekreti është të tërheqë sipërmarrës dhe investitorë të suksesshëm të cilët do të përfshihen në përparimin e vendit nikoqir dhe në përparimin e ekonomisë. Ky dekret është pjesë e përpjekjeve që Maqedonia e Veriut po bën për t'u përafëruar me qasjen e këtyre programeve, në mënyrë që të përputhet me politikat e BE-së, dhe të fitojë më shumë përfitime për qytetarët e saj dhe për qëllimet ekonomike nacionale.

Ky program specifik i Shtetësisë nga Investimet i referohet investitorëve që investojnë kapital në një fond investimi të dizajnuar për investime ekskluzive në baza afatgjata në projektet strategjike në Maqedoninë e Veriut. Përveç kësaj, një pjesë e mjeteve të fondeve investuese do të ndahen për mbështetje të drejtpërdrejtë të startapeve dhe kompanive inovative, të cilat do të kontribuojnë më tej në zhvillimin e tregut të kapitalit privat maqedonas, si dhe të gjithë ekosistemit të startapeve.

Programet e shtetësisë ekonomike kanë provuar rezultate të shkëlqyera për vendet që i zbatojnë ato, si Mali i Zi, Malta, Qipro, Greqia, Turqia, Hungaria, Moldavia, Bullgaria, Portugalia, Britania e Madhe, Irlanda, Kanadaja, Australia, SHBA.

Vendet që ofrojnë shtetësinë me investime tërheqin investitorë të mëdhenj, të cilët ndikojnë pozitivisht në ekonomi duke rritur PBB-në, punësimin, duke rritur portofolin e investimeve, taksat dhe detyrimet ndaj shtetit mbi baza të ndryshme, duke krijuar një inkubator ndërkombëtar/rajonat të biznesit të investimeve, si dhe duke rritur tregtinë me biznes-habin origjinal të investitorit. Vendi nikoqir në këto raste ka edhe përfitime indirekte për sa i përket përdorimit të nënkontraktorëve të Maqedonisë, sektorit financiar dhe të ngjashme.

✓ Partneritetet

Fondi do të mbajë dhe zhvillojë vazhdimisht partneritete të reja me disa institucione dhe organizata kryesore që veprojnë në sektorin e NMVM-ve, dhe në sektorin e inovacionit, kërkimit dhe zhvillimit nëpërmjet organizimit të ngjarjeve informative, pjesëmarrjes në konferenca, punëtori, debate dhe aktivitete të tjera.

Fondi do të vazhdojë bashkëpunimin e tij me Zyrën e kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe Kabinetin e zëvendëskryeministrit përgjegjës për Punët Ekonomike dhe Koordinimin me Portofolat dhe Investimet Ekonomike, me qëllim të zbatimit të Planit të Rritjes Ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ne gjithashtu do të punojmë në mënyrë aktive për të krijuar bashkëpunim rajonal dhe partneritete lokale në mënyrë që të rrisim transparencën dhe disponueshmërinë e instrumenteve dhe programeve të Fondit, për sa më shumë ndërmarrje inovative të jetë e mundur, si dhe për të rritur në përgjithësi mobilitetin qytetar.

✓ **BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT VENDAS:**

**Shoqata Bankare e Maqedonisë:**

**Fondi vazhdon bashkëpunimin me SHBM (Shoqatën Bankare të Maqedonisë) në bazë të memorandumit të nënshkruar të bashkëpunimit për aktivitetet që kanë të bëjnë me objektivat e mëposhtme:**

1. Inkurajimi dhe promovimi i aktiviteteve me interes të përbashkët;
2. Promovimi i mundësisë së financimit dhe lehtësimit të qasjes në kapital për ndërmarrjet mikro, të vogla, të mesme dhe startap kompanive ;
3. Promovimi i inovacionit dhe zhvillimit teknologjik në vend;
4. Promovimi i rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke nxitur një kulturë sipërmarrëse.

**Odat Ekonomike, Shoqatat e Biznesit dhe Shoqëritë e Biznesit:**

**Në kuadër të aktiviteteve të rregullta të Fondit, planifikohet forcimi i bashkëpunimit me Odat Ekonomike në vend, me shoqatat dhe shoqëritë e biznesit, me qëllim:**

- informimi i rregullt për aktivitetet e Fondit,
- bashkëpunimi në fushën e marrjes së propozimeve për nevojat e sektorit privat gjatë krijimit të programeve për mbështetjen e tij,
- informimi për rezultatet e thirrjeve,
- kryerja e ngjarjeve të përbashkëta për të informuar anëtarësinë për mundësitë e financimit nëpërmjet Fondit,
- aktivitete të tjera që lidhen me forcimin e dialogut me sektorin privat.

**Asociacioni i komunitetit startap i Republikës së Maqedonisë së Veriut STARTAP MAQEDONIA**

Për të zbatuar dhe forcuar bashkëpunimin e ndërsjellë, si dhe për të drejtuar përpjekjet tona për të inkurajuar dhe afirmuar fushat me interes të përbashkët, kryesisht në fushën e inovacionit dhe startapeve, ne vazhdojmë të promovojmë bashkëpunimin me Shoqatën e Komunitetit Startap të Republikës së Maqedonisë së Veriut STARTAP MAQEDONI.

**Bashkëpunimi i ndërsjellë do të synojë zhvillimin dhe avancimin e veprimtarisë së inovacionit dhe komunitetit të startapeve duke digjitalizuar ekosistemin e startapeve dhe të dhënat e disponueshme në mënyrë transparente. Disa nga aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij memorandumit janë përmirësimi i legjislacionit për kompanitë fillestare, përgatitja e hulumtimit vjetor dhe raportit mbi progresin e ekosistemit fillestar, organizimi i Samitit Nacional të Startapeve, si dhe afrimi i kompanive fillestare me tregun e huaj.**

Fondi do të krijojë dhe do të mbajë bashkëpunim me partnerë të tjerë vendas, institucione, shoqata, organizata, etj; për të arritur objektivat kryesore të Fondit dhe për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë vendase.

### **Fakulteti i Filozofisë Shkup**

**Bazuar në Memorandumin e nënshkruar ndërmjet Fondit dhe Fakultetit të Filozofisë në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" Shkup, vitin e ardhshëm do të vazhdojë bashkëpunimin, qëllimi kryesor i të cilit do të jetë promovimi i arsimit dhe inovacionit në procesin arsimor. Do të punohet në mbështetjen e ngjarjeve mësimore-shkencore, që promovojnë konceptin e inovacionit në arsim, shkencë dhe shoqëri, si dhe ekspertizën profesionale dhe shkencore nga fusha e shkencave humane dhe sociale për nevojat e Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik.**

### **INOFEIT Habi i Inovacionit Digjital (HID) dhe Programi Zviceran për Rritjen e Punësimit në Treg (IME)**

Me qëllim të krijimit dhe promovimit të mekanizmave për mbështetjen e proceseve të transformimit digjital në mesin e kompanive të Maqedonisë nëpërmjet futjes dhe aplikimit të zgjidhjeve digjitale, FIZHT në shtator 2022 nënshkroi Memorandumin e bashkëpunimit me Habin e Inovacionit Digjital (HID) të INOFEIT, që vepron në kuadër të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi", në Shkup – Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe i Teknologjive të Informacionit (FEIT) dhe Programi Zviceran për Rritjen e Punësimit në Treg (IME).

Ky bashkëpunim thekson rëndësinë e transformimit digjital të proceseve kyç në kompani, i cili është thelbësor për rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës së kompanive së Maqedonisë dhe ekonomisë në tërësi.

Bashkëpunimi me INOFEIT dhe IME do të vazhdojë në vitin 2023, me aktivitete të reja që synojnë arritjen e objektivave të Memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar.

### **Qendrat Rajonale të Biznesit në kuadër të Qendrave për Zhvillimin e Rajoneve Planore**

Në bazë të memorandumit të nënshkruar ndërmjet Fondit dhe Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale në kuadër të projektit "Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës i balancuar rajonal", bashkëpunimi do të vazhdojë, qëllimi kryesor i të cilit është zvogëlimi i dallimeve në zhvillim ndërmjet dhe brenda rajoneve planore, të cilat do të kontribuojnë në kushte më të mira të jetesës për të gjithë qytetarët. Me qëllim të inkurajimit të zhvillimit të balancuar rajonal, Fondi do të përqendrohet në rritjen e pranisë së tij dhe përmirësimin e qasjes në financa për përfituesit e mundshëm jashtë rajonit të Shkupit në 7 rajonet e tjera planore, nëpërmjet bashkëpunimit me zyrat ekzistuese për zhvillimin e rajoneve planifikuese, si dhe hapjen e startap haveve në të gjithë vendin nëpërmjet modelit të konvertimit të objekteve shtetërore që nuk përdoren.

### **"Maqedonia 2025":**

Vitin e ardhshëm, Fondi do të vazhdojë bashkëpunimin e tij me "Maqedonia 2025", veçanërisht në fushën e organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje të përbashkëta, si dhe ofrimin e asistencës mentoruese dhe këshilluese për ndërmarrjet e Maqedonisë, organizimin e takimeve të biznesit (B2B) dhe animimin e diasporës në drejtim të engjëjve të mundshëm të biznesit dhe investimin në startape vendase , etj.

### **Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AKE) /Qendra Nacionale e Reagimit ndaj Incidenteve Kompjuterike (MK-CIRT)**

FIZHT në kuadër të Memorandumit të bashkëpunimit me Agjencinë e Komunikimeve Elektronike (AKE) – Qendra Nacionale e Reagimit ndaj Incidenteve Kompjuterike (MK-CIRT) gjatë vitit 2023 do të zbatojë projekte të përbashkëta në fushën e inovacionit dhe të sigurisë kibernetike duke përdorur mekanizmat ekzistues për të mbështetur institucionet nënshkruese të Memorandumit.

### **Komisioni i Letrave me Vlerë**

FIZHT dhe Komisioni i Letrave me Vlerë e thellojnë bashkëpunimin, me qëllim shkëmbimin dhe përdorimin e të dhënave në lidhje me fondet e investimeve private dhe mbështetjen e Fondit për krijimin ose pjesëmarrjen në fondet e investimeve private. Të dyja institucionet gjithashtu do të punojnë për të përcaktuar një interes të veçantë ekonomik në marrjen e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas rregulloreve në fuqi.

## **✓ BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË**

### **Banka Botërore**

Bashkëpunimi me Bankën Botërore vazhdon edhe në të ardhmen në fushën e "Innovation and Competitiveness Ecosystem TA". Bashkëpunimi nuk kufizohet vetëm në këtë segment, por Fondi do të ruajë bashkëpunimin strategjik me Bankën Botërore në fushën e ndërtimit të kapaciteteve të institucioneve, mbështetjes së zhvillimit dhe programeve të financimit të sektorit privat, veçanërisht në fushën e zhvillimit aksionar, financimit të kapitalit të rrezikut dhe të ngjashme.

### **Delegacioni i Bashkimit European**

Me qëllim të zbatimit të aktiviteteve mbështetëse të sektorit privat, Fondi vazhdon bashkëpunimin me Delegacionin e Bashkimit European, veçanërisht në fushën e mbështetjes së sektorit privat në zbatimin e aktiviteteve që lidhen me "EU Green Deal" (Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së), si dhe forcimin e kapaciteteve të Fondit për zbatimin e aktiviteteve që lidhen me "Green Deal".

### **Komisioni European**

Nga viti 2023, Fondi do të vazhdojë të funksionojë me Pikën Nacionale të Kontaktit për European Innovation Council- Programin european për identifikimin, zhvillimin dhe rritjen e inovacioneve dhe teknologjive të reja dhe Pikën Nacionale të Kontaktit për European Innovation Ecosystems – Programin european për lidhjen dhe bashkëpunimin e ekosistemeve europiane nacionale, rajonale dhe lokale të inovacionit brenda Horizont Europa. Duke ofruar informacion në lidhje me mundësitë që këto programe ofrojnë për kompanitë e Maqedonisë, organizatat kërkimore dhe aktorët e tjerë të ekosistemit të inovacionit, Fondi do të sigurojë një nxitje shtesë për shfrytëzimin e fondeve europiane dhe bashkëpunimin e aktorëve vendas me aktorët europianë.

## **Instituti European i Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT)**

Në vitin 2023, Fondi do të bashkëpunojë me EIT Community Regional Innovation Scheme Hub të sapo krijuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Skema Rajonale e Inovacionit EIT synon të ndajë informacionin dhe njohuritë e komunitetit të EIT-së, dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e palëve të interesuara të Maqedonisë në aktivitetet e Komuniteteve të Njohurive dhe Inovacionit të EIT-ve. Fondi në bashkëpunim me Sekretarin Kombëtar të EIT habit në Maqedoninë e Veriut, do të veprojë drejt forcimit të kapaciteteve të komunitetit akademik, sektorit privat dhe sektorit civil për të përfituar nga mundësitë e ofruara nga EIT.

## **Fondacioni European i Trajnimit (ETF)**

Në kuadër të bashkëpunimit me Fondacionin European të Trajnimit (European Training Foundation-ETF), në tetor 2023, është planifikuar të organizohet një ngjarje ndërkombëtare për rrjetëzimin e sektorit agro-ushqimor nga Ballkani Perëndimor në Shkup, dhe në të njëjtin FIZHt do të jetë partneri kryesor i ETF dhe nikoqir i ngjarjes. Aktiviteti do të organizohet në kuadër të projektit ETF “Skilling up the Western Balkan agri-food sector: digitalising, greening”, i cili filloi në qershor 2022. Qëllimi i ngjarjes do të jetë të sjellë në një vend NVM-të inovative nga sektori agro-ushqimor, sektori i TIK-ut, shoqatat e biznesit, institucionet arsimore, trajnimi dhe kërkime të përfshira në inovacion, kualifikim dhe rikualifikim të fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë në Europë.

## **Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar**

Bashkëpunimi me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar vazhdon edhe në periudhën e ardhshme, sepse nëpërmjet fondit britanik “Good Governance and Investment Climate Reform – (GGICR)” financohet asistencë teknike “Innovation and Competitiveness Ecosystem TA”, e cila synon të identifikojë aktivitetet që do ta bëjnë ekosistemin për inovacion dhe konkurrencë në nivelin e sektorit privat më efikas dhe konkurrues. Qëllimi i mbështetjes është të përfitojë ekonomia e Maqedonisë së Veriut, duke përmirësuar aftësitë inovative të kompanive, të cilat do të kontribuojnë në forcimin e rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

## **Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit (RCC- Regional Cooperation Council) dhe Forumi Ekonomik Botëror (WEF-WEF – World Economic Forum)**

Në periudhën e ardhshme, Fondi do të vazhdojë bashkëpunimin e tij me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC— Regional Cooperation Council) dhe Forumin Ekonomik Botëror (WEF— World economic forum) në kuadër të „Innovation and Competitiveness Accelerator“ së Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të akseleratorit, Fondi, së bashku me përfaqësuesit ekonomikë nga Ballkani Perëndimor dhe përfaqësues nga RCC dhe WEF, do të vazhdojë me aktivitetet që lidhen me “Regional Early Stage Innovation Funding Scheme”, pra krijimin e një skeme rajonale të financimit për ndërmarrjet në fazën e hershme. Fudnja, ky aktivitet është gjithashtu pjesë e planit të veprimit të MAP REA 2021-2024 në seksionin “8.1 Regional Innovation”, si pjesë e Procesit të Berlinit për Ballkanin Perëndimor.

## **Programi për zhvillim i KB-ve (UNDP)**



Bashkëpunimi i Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), i cili u forcua në vitin 2020 me nënshkrimin e Memorandumit të bashkëpunimit, do të vazhdojë gjatë vitit të ardhshëm. Planifikohet të vazhdojnë aktivitetet e planifikuara duke forcuar aktivitetet e inovacionit dhe duke futur procese inovative në sektorin publik, duke mbështetur rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, duke promovuar modele kërkimore dhe efektive të menaxhimit, si dhe duke rritur bashkëpunimin ndërmjet sektorit publik, privat dhe joqeveritar. Të dyja institucionet do të vazhdojnë të mbështesin rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme duke zbatuar zgjidhje dhe shërbime inovative; duke bashkëpunuar me ndërmarrjet vendase për të qenë në gjendje të arrijnë qëllimet e tyre të zhvillimit të qëndrueshëm së bashku me agjencitë e zhvillimit dhe institucionet publike; avancimin dhe promovimin e zhvillimit afatgjatë nëpërmjet përmirësimeve teknologjike dhe mbështetjen e zhvillimit të aftësive digjitale, që duhet të kontribuojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe përfshirjen e grave në shkencat teknike dhe natyrore dhe në projektet komerciale për të zvogëluar pabarazinë gjinore në tregun e punës. Fondi dhe UNDP do të vazhdojnë të punojnë për të rritur ndërgjegjësimin për qasjet e reja inovative, përmirësimet teknologjike, transferimin e njohurive në të gjithë industrinë dhe promovimin e kërkimit ndërmjet sektorit akademik dhe privat.

### **Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)**

Në vitin 2021, Fondi nënshkroi me UNICEF një Memorandum të ri bashkëpunimi për periudhën 2021-2023, për të siguruar mbështetje të vazhdueshme në zbatimin e Programit “Programi i sipërmarrësisë sociale për rininë – UpShift”. UpShift angazhon të rinjtë në proceset shoqërore duke u dhënë atyre një pozicion udhëheqës në njohjen e problemeve në komunitetin e tyre, dhe më pas duke punuar me komunitetin për të krijuar zgjidhje, shërbime ose produkte që adresojnë problemet e identifikuara. Ky “dizajn i përqendruar në përdoruesin” dhe mësimi i sipërmarrësisë u lejon të rinjve të zhvillojnë të menduarit kritik, dhe të fitojnë aftësi të shekullit 21, që mund të zbatohen në të gjitha fushat e jetës.

### **Ambasada e Zvicrës**

Me memorandumun e nënshkruar ndërmjet Fondit dhe Programit Zviceran për sipërmarrësi (Swiss Entrepreneurship Programme – Swiss EP) të Ambasadës së Zvicrës në Maqedoninë e Veriut, bashkëpunimi do të vazhdojë, qëllimi kryesor i të cilit është mbështetja e zhvillimit të inovacionit dhe sipërmarrësisë në vend, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe sipërmarrësve, si dhe mbështetja individuale për përmirësimin e kapaciteteve institucionale, të cilat janë aspektet kryesore të këtij memorandum. E gjithë kjo do të zbatohet nëpërmjet një sërë aktivitetesh si mentorimi i ekspertëve, trajnimi për përgatitjen e modeleve të biznesit dhe strategjive të komunikimit, ofrimi i mbështetjes për engjëjt e biznesit dhe investitorët, si dhe krijimi i një sistemi për monitorimin e progresit të kompanive që punojnë në projekte inovative dhe aktivitete të ngjashme.

Në vitin 2023, Fondi do të vazhdojë të thellojë bashkëpunimin në kuadër të projekteve të financuara nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

### **Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)**

Fondi do të vazhdojë bashkëpunimin e tij me USAID-in, me qëllim përmirësimin e ekosistemit të biznesit, mbështetjen e sipërmarrësisë dhe startup bizneseve, me qëllim forcimin e kapaciteteve të sektorit privat dhe rritjen e konkurrencës së tij.

Në vitin 2021, Fondi nënshkroi me USAID-in një Memorandum të ri bashkëpunimi për periudhën 2021-2024, për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për zbatimin e projektit

“Mbështetje për arsimin sipërmarrës në Europë dhe Euroazi – Xhunion Açivment”. Projekti, i zbatuar nga "Xhunion Açivment Europa" (Junior Achievement Europe), synon të frymëzojë dhe përgatisë të rinjtë që të kenë sukses në ekonominë globale nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të programeve të arsimit sipërmarrës, shkrim-leximit financiar dhe përgatitjes më të mirë për tregun e punës. Projekti bashkëpunon me shkollat e mesme, studentët, mësuesit, prindërit dhe organizatat e tjera si shoqatat e biznesit, institucionet financiare dhe kompanitë udhëheqëse që duan të mbështesin arsimin sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Projekti përmirëson partneritetin midis bizneseve dhe shkollave në mënyrë që të krijojë një brez të rinjsh të aftë për të aplikuar qasje dhe teknika inovative në aktivitetet e tyre mësimore, dhe njerëz që do të jenë të gatshëm për tregun modern të punës.

Në vitin 2023, Fondi do të vazhdojë të thellojë bashkëpunimin në kuadër të projekteve të financuara nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.

Bashkëpunimi me USAID në kuadër të Memorandumit të nënshkruar të Bashkëpunimit është parashikuar edhe në Planin e Veprimit në kuadër të Dialogut Strategjik me Shtetet e Bashkuara, si pika 8 e Kapitullit VI (Tregtia dhe Investimet), i planifikuar për vitin 2023. Përveç kësaj, si pjesë e Dialogut Strategjik me Shtetet e Bashkuara, Masa 7 parashikon lidhjen e Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik (FIZHT) me institucione të ngjashme (publike ose private) të përfshira në përgatitjen e programeve mbështetëse për sektorin privat – startape dhe kompanitë inovative – në formën e shkëmbimit të përvojave, d.m.th. shkëmbimin e përvojave të tyre në përgatitjen dhe zbatimin e programeve dhe mekanizmave për të mbështetur kompanitë në zhvillim, me qëllim forcimin e kapaciteteve të FIZHT, dhe për të vazhduar me tendencat dhe praktikatat më të fundit amerikane për të siguruar mbështetje për sektorin privat.

### **Shteti i Izraelit**

Fondi vazhdon bashkëpunimin me shtetin e Izraelit nëpërmjet Ambasadës së Izraelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Bashkëpunimi ka për qëllim të përfshijë forcimin e bizneseve të Maqedonisë, dhe në veçanti komunitetin e startapeve të Maqedonisë duke lidhur kompanitë izraelite dhe ato të Maqedonisë; organizimin dhe pjesëmarrjen në ngjarje të përbashkëta; organizimin e takimeve të biznesit (B2B); asistencën e mentorimit dhe konsultimit; shkëmbimin e përvojave dhe njohurive midis bizneseve izraelite, veçanërisht startap bizneseve dhe përfaqësuesve të sipërmarrjeve të Maqedonisë; organizimin dhe zbatimin e vizitave studimore të kompanive të Maqedonisë në Izrael, etj.

### **Instituti Jozhef Stefan në Lubjanë**

Fondi filloi bashkëpunimin me institutin kryesor kërkimor në Slloveni për të siguruar mbështetje, për zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Nacionale për Inteligjencën Artificiale dhe ndërtimin e partneritetit, në mënyrë që të lidhë sektorin akademik dhe privat në vend me të njëjtën në Slloveni për të zbatuar iniciativa dhe projekte të përbashkëta. Fondi do të vazhdojë të punojë në ndërtimin e marrëdhënieve me institutin dhe krijimin e partneritetit.

### **Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ**

Memorandumi i nënshkruar ndërmjet Fondit dhe Projektit "BE për rritje ekonomike" (EU for Economic Growth Project – EU4EG) i zbatuar nga zyra GIZ në Maqedoninë e Veriut, do të iniciojë bashkëpunimin, qëllimi kryesor i së cilës është të sigurojë mbështetje për startapet dhe NVM-të në rajonet e synuara të projektit. Fondi do të mbështesë aktivitetet e projektit EU4EG dhe do të kontribuojë në arritjen e objektivave të tij.

#### **✓ Partneritete të tjera**

Në periudhën e ardhshme do të identifikojmë në mënyrë aktive burime të reja të financimit dhe partneriteteve për pjesëmarrjen dhe zbatimin e projekteve nacionale dhe shumëkombëshe. Fondi do të marrë pjesë në mënyrë aktive në ngjarjet e organizuara nga institucionet ndërkombëtare, në veçanti institucionet e Bashkimit European përgjegjëse për arsimin, shkencën, kërkimin dhe inovacionin, mbështetjen e sektorit privat si European Investment Bank, European Institute of Innovation and Technology, Joint Research Centre, DG Research and Innovation, European Research Foundation and Education, Audiovisual and Culture Agency dhe të tjerët.

#### ✓ **Sfidat tematike**

Nxitja e inovacionit në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë, por edhe të shoqërisë në tërësi, në pajtim me politikat dhe programet e miratuara ndërkombëtare, si dhe legjislacioni ekzistues dhe Strategjia e Inovacionit është një nga prioritetet tona.

Duke filluar nga sa më sipër gjatë vitit 2023, Fondi do të krijojë thirrje publike për përzgjedhjen e zgjidhjeve inovative për sfidat në fushat e mëposhtme:

### **1. Ekonomia e Gjellbër**

Ekonomia e gjellbër siguron potencialin për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet rritjes që është rezistent ndaj degradimit të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, dhe siguron ushqim, ujë dhe energji për të gjithë njerëzit. Ajo bazohet në gjashtë shtylla: ndryshimi i klimës; ruajtja dhe menaxhimi i burimeve; ekonomia rrethore; mbrojtja e mjedisit; mbrojtja e ekosistemit; ruajtja e ujit dhe parandalimi i fatkeqësive natyrore.

Duke njohur rëndësinë e zhvillimit të ekonomisë së gjellbër, Fondi do të vazhdojë të organizojë sfida që mundësojnë punësimin dhe rritjen e të ardhurave nëpërmjet investimeve në zgjidhje dhe mjete, që do të sigurojnë uljen e emetimeve dhe ndotjes, rritjen e efikasitetit të energjisë dhe burimeve, dhe parandalimin e humbjes së biodiversitetit dhe mbrojtjen e ekosistemit.

#### ✓ **SMART FIZHT - Digjitalizimi i proceseve në FIZHT**

Me qëllim digjitalizimin e punëve, veçanërisht në pjesën e monitorimit të portofolit të Fondit si dhe monitorimit të përdoruesve, në kuadër të Programit afatmesëm për periudhën 2021-2023, prokurimi/përpunimi i një mjeti/softueri plotësisht të digjitalizuar për monitorimin dhe ndjekjen e ecurisë së përdoruesve të FIZHT-it, si dhe ndjekja i portofolit të projekteve të mbështetura.

Qëllimi i krijimit të tij buron nga nevoja për ekzistencën e një mjeti digjital, pra të një sistemi informacioni menaxhues nëpërmjet të cilit, në një periudhë shumë të shkurtër kohore, do të siguroheshin të dhëna që lidhen me: historinë e çdo përdoruesi të fondeve, fazën e realizimit të projektit, dhe të ngjashme.

Nëpërmjet kësaj platforme digjitale, do të parashikohen module në zgjidhjen softuerike që do të mundësojnë që i gjithë procesi nga aplikimi deri te monitorimi, dhe përfundimi i projekteve

të realizohet në mënyrë elektronike. Përveç kësaj, do të ofrohen module që synojnë përmirësimin e efikasitetit dhe profesionalizmit të proceseve të brendshme në FIZHT (menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i mjeteve fikse, caktimi dhe monitorimi i aktiviteteve dhe detyrave të punonjësve dhe punonjësve në FIZHT, arkivi digjital, etj.). Një zgjidhje e tillë do të ndikojë seriozisht në digjitalizimin e proceseve dhe shërbimeve të kryera nga FIZHT.

#### ✓ **Siguria kibernetike**

FIZHT do të organizojë një sfidë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të mbështetur inovacionin në fushën e sigurisë kibernetike dhe promovimin e praktikave të mira, dhe përfshirjen e sigurisë kibernetike në inovacion në një infrastrukturë të hapur, ndërvepruese, të sigurt dhe të mbrojtur.

### **SHTYLLA 3 – EKOSISTEMI STARTAP**

Analiza e portofolit të FIZHT dhe trendet në ekonominë vendore tregojnë se kompanitë startap, janë bartëse të zhvillimit dhe inovacionit në Maqedoninë e Veriut. Mbi 50% e kompanive të mbështetura nëpërmjet instrumenteve të Fondit në periudhën 2017-2020, janë kompani të sapothemeluara me një vëllim total investimi prej 27 milionë euro.

Për shkak të kësaj, për herë të parë po aplikojmë një shtyllë të veçantë për startapet, nëpërmjet së cilës do të zhvillojmë një strategji të veçantë, me qëllim rritjen e mbështetjes për inovatorët dhe inkurajimin e rritjes së numrit të startapeve, që do të kontribuojnë në stabilizimin dhe zhvillimin e ekonomisë së Maqedonisë. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është pozicionimi i vendit si një qendër rajonale startap dhe një qendër rajonale hab, ku të rinjtë do të mund të realizojnë idetë e tyre të biznesit.

Ky synim do të arrihet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme

- **Startap Këshill** - Në vitin 2021 u formua një organ i veçantë këshillues, qëllimi kryesor i të cilit është të përfaqësojë komunitetin startap, dhe të përfaqësojë interesat e tij në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave që duhet të kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të startap ekosistemit të Maqedonisë. Këshilli gjithashtu përpunoi dokumentin e parë me [masat e propozuara për rritjen e përsheptuar të ekosistemit startap](#) që u njoftua publikisht, në mënyrë që të mobilizojë palët kryesore të interesit në ekosistem drejt realizimit të tyre. Detyra kryesore e Këshillit mbetet gjetja e problemeve dhe ofrimi i propozimeve për zgjidhje që do të plotësojnë nevojat reale të sipërmarrësve ose startapeve. Këshilli do të jetë pjesëmarrës aktiv në krijimin e politikave të ardhshme në lidhje me këto kompani, do të propozojë masa që synojnë përmirësimin e organizimit të punës së sektorit publik dhe institucioneve, të cilat do të rezultojnë në procedura të thjeshtuara dhe shërbime publike më të mira, si dhe rekomandime për uljen e barrës dhe kostos për startapet me ndërhyrje në rregullativën ligjore dhe kornizën ligjore, me qëllim lehtësimin e aksesit në kapital dhe mobilizimin e tij.

- **Startup Hab** ose Hab për inovacione digjitale (HID) – hapja e një thirrjeje për financim të qendrave në të gjithë vendin duke përshtatur objektet ekzistuese shtetërore, e cila është pjesë e strategjisë afatgjatë të Qeverisë për transformimin e objekteve të tilla të papërdorura në bashkëpunim me komunat. Qëllimi është që ato të shndërrohen në qendra rajonale startup, ose habe të inovacionit digjital, të cilat do të ofrojnë hapësirë për punë dhe një vend për rrjetëzim dhe shkëmbim përvojash të komunitetit të startapeve dhe qasje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM) në shërbime për digjitalizimin e punës së tyre. Përveç kësaj, do të punohet në futjen e një sistemi kuponi për shërbimet digjitale, i cili do të sigurohet nëpërmjet startup haveve ose Haveve të Inovacionit Digjital, dhe do të synohet për digjitalizimin e funksionimit të NVM-ve. Kuponat mund të përdoren për të ndërtuar aftësi digjitale, për të zhvilluar një strategji për digjitalizim, marketingun digjital, mbrojtjen kibernetike dhe të ngjashme. Bazuar në përvojën nga ky projekt, në tre vitet e ardhshme do të hapen startup habe të tilla rajonale në katër rajone të tjera, të cilat do të synojnë të nxisin zhvillimin lokal dhe sipërmarrësinë. Ky aktivitet duhet të kontribuojë edhe në zhvillimin më të mirë ekonomik rajonal në të gjitha rajonet planore.
- **Partneritetet** - Lidhjen e partneriteteve dhe bashkëpunimit me habet ekzistuese në të gjithë vendin për promovimin e aktiviteteve dhe programeve të FIZHT-it. Qëllimi është të ofrohet qasje më e lehtë në programet dhe aktivitetet e Fondit, për të inkurajuar më shumë kompani që të punojnë në projekte zhvillimore dhe inovative, dhe të aplikojnë për mbështetje financiare nëpërmjet instrumenteve të Fondit. Gjithashtu, në kuadër të këtij bashkëpunimi, programet tona arsimore dhe mentoruese do të jenë në dispozicion të një game më të gjerë të aplikantëve potencialë dhe kompanive vendore.
- **Programi i nomadëve digjitalë** – përfshin lehtësimin e procedurave dhe veprimeve për qëndrim dhe punë në vend për sipërmarrësit nga jashtë, në mënyrë që t'i tërheqim ata të vijnë të punojnë dhe të jetojnë në Maqedoninë e Veriut, duke e pozicionuar atë si një destinacion tërheqës për biznes për shkak të vendndodhjes dhe kushteve të jetesës. Për këtë qëllim, Fondi në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme do të krijojë një grup pune që do të punojë për ndryshimin e Ligjit e të Huajve, i cili do të lejojë të ashtuquajturit "nomadë digjitalë", që do të plotësojnë kriteret e paracaktuara për t'u mundësuar qëndrimi dhe leja për të punuar. Projektligji për ndryshimin e Ligjit të të Huajve u [publikua në ENER](#) dhe pritet të hyjë në procedurë parlamentare gjatë vitit 2022. Ky program do të përfshijë mundësinë për të marrë një vizë online, procedura të lehtësuara dhe ndihmë administrative, si dhe lidhjen e sipërmarrësve dhe ekspertëve të huaj të miratuar me startup komunitetin e Maqedonisë për shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe mundësinë për të hyrë në tregjet e huaja. Tërheqja e talenteve të tilla do të ndikojë pozitivisht në ekonominë vendore, dhe do të mundësojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet sipërmarrësve të Maqedonisë dhe sipërmarrësve ndërkombëtarë.

- **Zhvillimi i një programi të ri mentorimi për 4 grupe të synuara** – Në kuadër të Programit të mentorimit aplikohen programe speciale të krijuara dhe të destinuara për grupe të ndryshme të synuara: përdorues të mundshëm, përdorues aktivë, aplikues, projektet e të cilëve nuk janë miratuar për bashkëfinancim dhe përdorues me potencial për rritje të shpejtë. Pritet që një qasje e tillë e synuar do të rrisë cilësinë e shërbimeve të Fondit dhe cilësinë e projektpropozimeve të dorëzuara.
- **Samiti Startup – Një herë në vit, do të organizohet një samit, ku do të marrin pjesë pedagogë vendas dhe botërorë, i cili do të përqendrohet në tendencat lokale dhe globale në botën e startapeve, por edhe në vend.** Ky event do të jetë një mundësi për të shkëmbyer përvoja, dhe për t'i zbatuar ato në kompanitë vendore.

#### **SHTYLLA 4 – SISTEMI HELIKS I TREFISHTË/KATËRFISHTË**

Indeksi Global i Inovacionit (2022) e rendit Republikën e Maqedonisë së Veriut në vendin e 66-të nga 132 ekonomi, dhe sipas Pikëzimit European të Inovacionit (2022), Republika e Maqedonisë së Veriut cilësohet si një "novator në zhvillim" (emerging inovator) me një renditje nën mesataren europiane, por me një prirje pozitive të përparimit.

Trendet e zhvillimit tregojnë se ekonomia nacionale po bën përparim të moderuar, në raport me treguesit individualë të këtyre renditjeve ndërkombëtare. Ekosistemi nacional i inovacionit vazhdon të tregojë rezultate të mira në eksportin e teknologjive të larta, teknologjive mjedisore, numrit të studentëve doktorantë jashtë vendit, popullsisë me shkallë të tretë të arsimit të fituar dhe investimeve në inovacion, që nuk lidhen me kërkimin dhe zhvillimin. Në të njëjtën kohë, rezultatet vazhdimisht të dobëta në vendosjen e bashkëpunimeve midis sektorit privat dhe industrisë, si dhe investimet e ulëta në kërkime dhe zhvillim, janë të dukshme.

Për të kontribuar në përmirësimin e dobësive të identifikuara që ndikojnë ndjeshëm në intensitetin e aktivitetit të inovacionit në ekosistemin e përgjithshëm të inovacionit, Fondi do të zbatojë masa për të inkurajuar zhvillimin e një sistemi heliks të trefishtë/katërfishtë, d.m.th. për të lidhur dhe nxitur bashkëpunimin midis palëve të interesuara të ekosistemit të inovacionit, me fokus në forcimin e kapitalit njerëzor dhe bashkëpunimin e institucioneve arsimore dhe komunitetit akademik me sektorin privat, sektorin publik dhe sektorin civil.

Të gjitha masat e krijuara në drejtim të ndërtimit të një ekosistemi inovativ heliks të trefishtë/katërfishtë do të përpiqen për një zhvillim social të qëndrueshëm dhe transformues, në pajtim me tendencat moderne të zhvillimit global. Agjenda e gjelbër, digjitalizimi dhe kohezioni social janë prioritete horizontale që do të përfshihen në masat mbështetëse, dhe ato do të merren parasysh në hartimin dhe promovimin e të gjitha aktiviteteve të FIZHT-it. Gjithashtu, do të ketë aktivitete që synojnë promovimin e konceptit të "inovacionit të hapur", dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në procesin e identifikimit të sfidave sociale dhe zbatimin e zgjidhjeve.

Pas miratimit të Strategjisë së Specializimit të Zgjuar, Fondi do të ndërmarrë iniciativa për të përshtatur masat mbështetëse me sektorët prioritarë të specializimit, dhe për të identifikuar nisma të reja, sipas sektorëve prioritarë të përcaktuar.

#### **ARSIMI DHE TRAJNIMI**

Hulumtimi nëpërmjet një metodologjie të bazuar në njerëz që FIZHT-i kreu në vitin 2019, tregoi se pikat fillestare inkurajuese janë disa programe rinore në vend që kanë treguar rezultate

pozitive. Megjithatë, shumë prej tyre zbatohen në nivel projekti, gjë që paraqet vështirësi në drejtim të arritjes së ndikimit më të madh që do të nxiste ndryshime në nivel nacional. Është veçanërisht e rëndësishme të identifikohen problemet dhe mangësitë në sistem në mënyrë që të veprohet dhe të gjejnë zgjidhje, por është po aq e rëndësishme edhe njohja e shembujve pozitivë, praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra. Për të përmirësuar rezultatet e arritura nëpërmjet programeve rinore, si "UpShift", "Junior Achievement" dhe "Sfida për kërkuesit e rinj", nevojitet mbështetje sistematike gjithëpërfshirëse për të siguruar kohezion, konsistencë dhe qëndrueshmëri. Qasja e pamjaftueshme në informacion dhe mundësia për të identifikuar në mënyrë adekuate nevojat, dhe për të dëgjuar zërin e të rinjve dhe edukatorëve në këtë proces është gjithashtu një nga dobësitë më të rëndësishme të identifikuara të sistemit. Të rinjtë përballen me barriera sistematike për mirëqenien e tyre, dhe rrjedhimisht nevoja që qeveria, sektori privat, shoqëria civile, si dhe agjencitë nacionale dhe ndërkombëtare të mendojnë në mënyrë strategjike për të ardhmen e tyre, dhe t'i ndihmojnë ata të realizojnë potencialin e tyre. Në botën e sotme të ndryshimeve të shpejta të teknologjisë dhe ekonomisë globale, ekziston nevoja reale për aftësi shumë të specializuara dhe fleksibël, por edhe kushte që nxënësit dhe të rinjtë t'i zhvillojnë dhe t'i zbatojnë ato në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe transformues. Ndërkohë që sistemet arsimore dhe sistemet ekonomike përballen me probleme për të mbajtur ritmin me ndryshimin, nxënësit kanë nevojë për një arsim nga i cili mund të nxjerrin njohuri, vlera dhe përvoja të zbatueshme, dhe kompanitë kanë nevojë për transferimin e njohurive dhe teknologjive si dhe punonjës aftësitë dhe njohuritë e të cilëve do të jenë në gjendje të kapin hapin e zhvillimit global. Masat e FIZHT-it që synojnë zhvillimin e burimeve njerëzore dhe sistemi heliks trefish/katërfish synojnë krijimin e një ekosistemi që plotëson këto nevoja.

Në vitin 2023, Fondi do të vazhdojë të veprojë në mënyrë që të sigurojë mekanizma të qëndrueshëm dhe një qasje sistematike në drejtim të njohjes dhe rritjes së aftësive të të rinjve dhe parandalimin e ikjes së trurit. Fokusi do të jetë në nxitjen e inovacionit, kreativitetit, të menduarit kritik dhe aftësive të shekullit të 21-të:

- krijimi i një mjedisi stimulues intelektual dhe përgatitja e të rinjve për të ardhmen nëpërmjet aftësive për zgjidhjen e problemeve në një kontekst të ndryshimit të shpejtë;
- do të mbështesim sinergjinë midis fushave të ndryshme të arsimit dhe trajnimit;
- ne do të ofrojmë një platformë që do të lidhë sektorin e arsimit, sektorin e biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile;
- do të forcojmë zërin e rinisë.

#### 1. Një sfidë për kërkuesit e rinj

Nëpërmjet "Sfidës për kërkuesit e rinj", FIZHT mbështet projekte kërkimore të bazuara në metodën shkencore, duke përfshirë aspekte të tilla si: puna në grup, gjithpërfshirja, kohezioni social, etika e kërkimit dhe përfitimi socio-ekonomik. Në vitin 2023, do të shpallet një thirrje e re për Sfidën e kërkuesve të rinj – 6.

#### 2. Mbështetja e programeve të suksesshme të arsimit global që inkurajojnë të menduarit kritik, inovacionin, kreativitetin dhe SHTIAM te nxënësit dhe të rinjtë

Nëpërmjet mbështetjes së programeve të suksesshme arsimore globale, Fondi siguron qëndrueshmëri në nivel nacional të programeve që bashkëfinancohen nga donatorë ndërkombëtarë, si dhe përfshirjen e nxënësve dhe të rinjve nga Maqedonia në nismat globale.

Fondi do të vazhdojë bashkëfinancimin e "Junior Achievement" dhe "UpShift" si programe që inkurajojnë sipërmarrësinë të rinjtë dhe kompetencat në stafin mësimor duke aplikuar metodologji moderne arsimore dhe duke fituar përvojë praktike.

Programi Social Entrepreneurship for Youth – UpShift përmban: 1) të mësuarit nëpërmjet një metodologjie të dizajnit të përqendruar te njeriu; 2) mundësitë e mentorimit për të zhvilluar idetë në potencialin e tyre të plotë krijues; dhe 3) financimin e startup-eve për të mbështetur dhe angazhuar të rinjtë.

Qëllimi i Projektit për mbështetjen e arsimit sipërmarrës në Europë dhe Euroazi, i zbatuar nga Junior Achievement Europe, është të frymëzojë dhe përgatisë të rinjtë që të kenë sukses në ekonominë globale nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të programeve të arsimit sipërmarrës, shkrim-leximit financiar dhe gatishmërisë për punë. Projekti bashkëpunon me shkollat e mesme, studentët, mësuesit, prindërit dhe organizatat e tjera si shoqatat e biznesit, institucionet financiare dhe kompanitë udhëheqëse që duan të mbështesin arsimin sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Projekti përmirëson partneritetin midis bizneseve dhe shkollave në mënyrë që të krijojë një brez të rinjsh të aftë për të aplikuar qasje dhe teknika inovative në aktivitetet e tyre mësimore, dhe njerëz që do të jenë të gatshëm për tregun modern të punës.

### **3. Mbështetja e posaçmërisë shkencore-teknologjike, dhe sipërmarrësisë ndërmjet nxënësve dhe të rinjve**

Në varësi të periudhës së miratimit të Strategjisë për Specializim të Zgjuar, si dhe dinamikës së ndryshimit të kornizës ligjore, në periudhën 2023-2024 Fondi do të përgatisë aktet nënligjore dhe do të testojë masën për të mbështetur posaçmërinë shkencore dhe teknologjike dhe sipërmarrësisë te studentët dhe të rinjtë.

Qëllimi i kësaj mbështetjeje është të identifikojë potencialin e posaçmërisë dhe aftësisë së nxënësve dhe të rinjve në shkencë, teknologji, inxhinieri, art, matematikë (në tekstin e mëtejshëm "SHTIAM") dhe sipërmarrësi, për të forcuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në lidhje me bashkëmoshatarët e tyre në nivel botëror, t'u ofrojë të rinjve mundësi për të fituar përvoja ndërkombëtare, dhe të mësojnë nga bashkëmoshatarët e tyre në botë, si dhe t'u ofrojë atyre kushte për transferimin dhe zbatimin e këtyre përvojave, njohurive dhe aftësive në kontekstin më të gjerë shoqëror. Kjo masë do të financojë përgatitjen dhe pjesëmarrjen e nxënësve, nxënësve dhe të rinjve të Maqedonisë në garat dhe olimpiadat e themeluara ndërkombëtare.

### **4. Platforma e rrjetëzimit, mobilizimit dhe racionalizimit të burimeve**

Në varësi të periudhës së miratimit të Strategjisë së Specializimit të Zgjuar, si dhe dinamikës së ndryshimit të kornizës ligjore, në periudhën 2023-2024, Fondi do të vazhdojë të zhvillojë një platformë që do të synojë lidhjen e të rinjve, mësuesve, prindërve, institucioneve publike, sektorit civil, sektorit privat dhe donatorëve në drejtim të rrjetëzimit, mobilizimit dhe racionalizimit të burimeve. Platforma do të mundësojë funksionalitete të tilla crowd-funding dhe resource sharing për realizimin më të lehtë të iniciativave kërkimore dhe inovative të nxënësve dhe të rinjve.

Platforma do të ofrojë një përmbledhje të programeve, që do të shfaqin informacione rreth aktiviteteve që inkurajojnë kreativitetin, inovacionin dhe sipërmarrësinë te të rinjtë, si dhe përvetësimin e aftësive për shekullin e 21-të. Një shqyrtim i tillë i nismave do të kontribuojë në një koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve që i mbështesin dhe zbatojnë programet,



do të lehtësojë qasjen në informacion për palët e interesuara, duke rritur kështu vizibilitetin e programeve dhe duke ndikuar në zbatimin më të suksesshëm të tyre. Platforma do të shërbejë gjithashtu si bazë për analiza të mëtejshme të programeve ekzistuese për të identifikuar praktikatat e suksesshme, por edhe mangësitë në mbështetjen.

## **BASHKËPUNIMI NDËRMJET KOMUNITETIT AKADEMIK DHE KËRKIMOR SHKENCOR DHE SEKTORIT PRIVAT**

Për të vlerësuar gjendjen aktuale të ekosistemit nacional të inovacionit në vitin 2019, u përgatitën tre studime të qëndrueshmërisë të financuara nga BE-ja, në kuadër të projektit "Pëlhuara e Inovacionit: Rruga drejt Forcimit të Ekosistemit Nacional të Inovacionit". Një nga këto studime, "Studimi i Qëndrueshmërisë për Krijimin dhe Zbatimin e Instrumenteve të Politikës së Inovacionit", synonte të analizonte masat mbështetëse ekzistuese, dhe të identifikonte pajtimet dhe dobësitë në ekosistemin nacional të inovacionit. Mangësia kryesore ndërmjet masave për mbështetjen e inovacionit, kërkimit dhe zhvillimit është identifikuar në transferimin e njohurive ndërmjet sektorit publik dhe privat, si dhe në bashkëpunimin ndërmjet komunitetit akademik dhe industrisë. Në këtë drejtim, studimi konfirmon rekomandimet e OECD-së, për një qasje "hap pas hapi", duke filluar me ngjarje të shumta heliks të trefishtë, të ndjekur nga kuponët e inovacionit për bashkëpunim në shkallë të vogël dhe më pas me grante të konsiderueshme për bashkëpunim në projekte më të pjekura ndërmjet bizneseve dhe komunitetit akademik, për të cilin ka një interes të madh nga sektori privat. Studimi rekomandon gjithashtu që Fondi të marrë përsipër funksionin e lidhjes së Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe shkollave, universiteteve me sektorin e biznesit.

Në varësi të periudhës së miratimit të Strategjisë së Specializimit të Zgjuar, si dhe dinamikës së ndryshimit të kornizës ligjore, në vitet 2023-2024 Fondi do të fillojë të prezantojë masa të reja për të inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet komunitetit akademik dhe industrisë.

## **MBESHTETJA FINANCIARE**

### **Grantet e bashkëfinancuara për transferimin e teknologjisë**

Në vitin 2023, Fondi do të fillojë zhvillimin e një instrumenti të ri mbështetës – "Grante të bashkëfinancuara për transferimin e teknologjisë". Ky instrument do të synojë të inkurajojë veprimtaritë kërkimore dhe zhvillimore me potencial komercial, për të mbështetur krijimin e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit akademik dhe kërkimor-shkencor, me partnerët komercial me qëllim komercializimin e rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit. Në varësi të dinamikës së përpunimit dhe miratimit të Strategjisë së Specializimit të Zgjuar, instrumenti gjithashtu mund të inkurajojë veprimtari në pajtim me fushat prioritare të identifikuar.

### **INFRASTRUKTURA E INOVACIONIT**

#### **1. Zyra Nacionale e Transferimit të Teknologjisë**

Në vitin 2023, Fondi do të vazhdojë aktivitetet që synojnë krijimin e një Zyre Nacionale të Transferimit të Teknologjisë, e cila do të ofrojë shërbime që synojnë nxitjen e bashkëpunimit midis arsimit të lartë, institucioneve kërkimore shkencore dhe industrisë. Zyra Nacionale e Transferimit të Teknologjisë, do të ofrojë shërbime që lidhen me qasjen në financa, shërbimet ligjore dhe financiare, të drejtat e pronësisë intelektuale, menaxhimin e inovacionit dhe shërbime të tjera që lidhen me proceset e kërkimit dhe inovacionit në drejtim të transferimit të teknologjisë dhe transferimit të njohurive midis akademisë dhe sektorit privat.

#### **1. "Fab LABS" Laboratorët prodhues**

Gjatë vitit 2023, Fondi do të ndjekë dhe mbështesë punën e laboratorëve të themeluar për prodhimin "FAB LABS", të financuar në kuadër të Sfidës për themelimin e laboratorëve të prodhimit "FAB LABS", të zbatuar në vitin 2021. Sfida synon t'u sigurojë të rinjve kushte

hapësinore, materiale dhe teknike për zhvillimin e produkteve, shërbimeve, proceseve, aktiviteteve ose metodologjive inovative, të cilat ofrojnë zgjidhje praktike dhe të dobishme shoqërore për çështje ose probleme të caktuara në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë. Njëkohësisht, këto laboratorë do të jenë një vend për bashkëpunim ndërmjet sektorit privat, institucioneve të arsimit të lartë dhe shkencore, sipërmarrjeve dhe shoqatave civile. Laboratorët e prodhimit të themeluar nëpërmjet kësaj sfide janë të vendosura brenda institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, i plotësojnë disa kushte hapësinore dhe teknike, dhe janë një vend për lojë, krijim dhe shpikje. Këto laboratorë do t'u ofrojnë të rinjve qasje në teknologji të përparuara, nëpërmjet të cilave ata do të jenë në gjendje të materializojnë atë që kanë imagjinuar, një vend ku të rinjtë do të mësojnë dhe krijojnë duke inkurajuar inovacionin e tyre.

## **2. Laboratorët e kërkimit, krijimit dhe inovacionit të "MAKERSPACE"**

Gjatë vitit 2023, Fondi do të monitorojë dhe mbështesë punën e Laboratorëve të kërkimit, krijimit dhe inovacionit "MAKERSPACE", të financuar në kuadër të Sfidës së laboratorëve të kërkimit, krijimit dhe inovacionit të "MAKERSPACE", të shpallur në vitin 2022. MAKERSPACE është një hapësirë e hapur për krijuesit e rinj, dhe përmban një gamë të gjerë pajisjesh – si një inkubator i vërtetë i njohurive dhe teknologjisë për shekullin e 21-të. Këtu, të rinjtë do të marrin qasje falas, mbështetje mentorimi, kushte hapësinore dhe teknike për të ndërtuar një prototip të një zgjidhjeje inovative, që ata do të mund ta testojnë në një mjedis laboratorik, industrial dhe/ose në treg. Përdoruesit e këtyre laboratorëve do të kenë qasje të hapur në të gjitha përmbajtjet – nga bibliotekat, rrjetet kompjuterike deri te makineritë dhe mjete të ndryshme. Laboratorët gjithashtu mund të përshtaten për nevojat e sektorëve specifikë shkencorë dhe teknologjikë dhe/ose industrialë.

## **PROJEKTI "PËRGJIGJE NDAJ POLITIKAVE PUBLIKE "- "POLICY ANSWERS"**

Në vitin 2022, Fondi filloi zbatimin e projektit "Policy Answers" të financuar në kuadër të Programit Horizont Europa. Projekti mbështet dialogun në fushën e politikave të kërkimit dhe zhvillimit në nivelin e Ballkanit Perëndimor. Përveç mbështetjes për organizimin e takimeve formale ndërmjet zyrtarëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësuesve të Komisionit Europian, projekti ndihmon në krijimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në lidhje me "Agjendën e Ballkanit Perëndimor për Inovacion, Kërkim, Arsim, Rini dhe Sport"; forcon kapacitetet e palëve të interesuara përkatëse; dhe menaxhon me masat pilot që nxisin veprimtarinë shkencore dhe kërkimore, inovacionet dhe shkathtësitë lidhur me inovacionin në të gjitha fushat, me një fokus të veçantë në fushat prioritare – digjitalizimin, ekonominë e gjelbër dhe shoqëritë e shëndetshme.

Në vitin 2023, Fondi do të vazhdojë të zbatojë aktivitetet e projektit në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit. Kohëzgjatja e projektit është katër vjet, buxheti i përgjithshëm i projektit është 5 milion euro, dhe projekti do të zbatohet nga një shoqëri e përbërë nga gjithsej 14 anëtarë të udhëhequr nga Qendra e Inovacionit Social e Austrisë.

### **SHTYLLA 5 – NDIKIMI FIZHT**

- **Analiza e portofolit të përdoruesve të Fondit nga sektori privat**

Fondi do të vazhdojë të mbajë një bazë përdoruesish për programet e mbështetjes së sektorit privat, në mënyrë që të ketë një pasqyrë të portofolit total të Fondit sipas treguesve të ndryshëm:

- **Pasqyrë e shumës totale të mbështetjes financiare nga Fondi**
- **Pasqyrë e shumës totale të financimit vetanak nga sektori privat**
- **Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas instrumentit mbështetës**
- **Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas burimit të financimit**
- **Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas madhësisë së tyre**
- **Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas rajoneve planore**
- **Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas statusit të zbatimit**
- **Pasqyrë dhe analizë e përfaqësimit të grave si pronare/menaxhere në mesin e përdoruesve**
- **Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas industrisë**
- **Analiza e mbështetjes së startapeve në drejtim të një portofoli të plotë**

Shqyrtimi i totalit të portofolit të Fondit për mbështetjen e sektorit privat do të plotësohet në të ardhmen me tregues të rinj, sipas nevojave të analizës së Fondit.

- **Analiza e performancës financiare nga operacionet e përdoruesve të Fondit**

Fondi do të vazhdojë aktivitetet e analizës së punës së përdoruesve, me qëllim të monitorimit të lëvizjeve në zhvillimin e sipërmarrjeve-përdorues të mbështetjes financiare nga Fondi. Qëllimi i analizës është të vlerësojë ndikimin e mbështetjes financiare nga Fondi në punën e sipërmarrjeve, si dhe një analizë e tendencave, pra ritmeve të rritjes midis përdoruesve sipas treguesve të përcaktuar si:

- **Norma vjetore e rritjes së të ardhurave**
- **Norma e rritjes së fitimit të realizuar**
- **Pjesëmarrja mesatare e sipërmarrjeve që realizojnë fitim në portofolin e përgjithshëm të Fondit**
- **Shkalla e rritjes së numrit të punonjësve**
- **Norma e rritjes së pagës mesatare të paguar**
- **Norma e rritjes së mjeteve të derdhura në buxhet bazuar në tatimin mbi fitimin, kostot nga tatimet e pagave dhe kompensimet e pagave, dhe kontributet nga sigurimet sociale të detyrueshme**

Analiza e performancës financiare të përdoruesve mund të zgjerohet me tregues shtesë. Metodologjia e prodhimit mund të jetë analiza me thirrje, analiza me instrument mbështetës, analiza e punës së përdoruesve të Fondit dhe krahasimi i rezultateve me aplikuesit që nuk kanë marrë mbështetje nga Fondi dhe ngjashëm, me qëllim të njohjes së efekteve nga përdorimi i mbështetjes financiare nga Fondi.

## MARKETINGU DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

**Në vitin 2023, Fondi vazhdon me qasjen e vendosur multimediale në informimin e publikut dhe mekanizmave të komunikimit të dyanshëm, të cilat sigurojnë zbatimin më të mirë të programit FIZHT, përkatësisht rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e inovacionit në biznes, rritjen e interesit për instrumentet për të mbështetur Fondin dhe**

**përmirësimin e cilësisë së projekteve të propozuara dhe të paraqitura në thirrjet e hapura.**

**Strategjia afatgjate e FIZHT-it për investimin në shkathtësitë e sipërmarrësve dhe sektorit startap të Maqedonisë vazhdon nëpërmjet vebinareve të reja, diskutimeve në panel, ku do të marrin pjesë ekspertë botërorë dhe sipërmarrës të njohur nga një numër industrish.**

**Për këtë qëllim edhe në vitin 2023, ne vazhdojmë me:**

- **FIZHT CLASSROOM – vebinare mbi tema të ndryshme, që janë të rëndësishme për ekosistemin e startapeve ku ekspertët globalë nga markat më të mëdha në botë në fusha të ndryshme ndajnë përvojat dhe rekomandimet e tyre.**
- **FIZHT MASTERCLASS – prezantime nga sipërmarrës të markave të njohura.**

Gjatë vitit 2023, Fondi planifikon për herë të dytë të organizojë një **Samit Vjetor të Startapeve**, i cili do të përqendrohet në tendencat lokale dhe globale në botën e startapeve, por edhe në vend. Në këtë samit, ligjëruesit vendor dhe botërorë do të shkëmbejnë përvoja që mund të gjejnë zbatim në kompanitë vendore.

**Me qëllim të informimit më të mirë të publikut për misionin, objektivat, aktivitetet dhe instrumentet për mbështetjen e kompanive, FIZHT planifikon të hapë INFO-QENDRA nëpër qytete të ndryshme në vend. Në fazën e parë, gjatë vitit 2023, qendra të tilla informative janë planifikuar të hapen në Manastir dhe Tetovë. Sipas rezultateve të punës së tyre, Fondi mund të vazhdojë të hapë qendra informacioni në qytete të tjera në të gjithë vendin.**

Gjatë vitit 2023, FIZHT do të shënojë jubileun – 10 vjeçar të ekzistencës së tij. Për jubileun, do të organizohet një ngjarje publike për të promovuar punën e suksesshme të FIZHT-it ndër vite, aktivitetet e realizuara në periudhën e kaluar, si dhe vizionin për zhvillimin e ardhshëm të FIZHT-it.

Fondi, në këtë vit kalendarik, do të vazhdojë të punojë në programet për përmirësimin e marrëdhënieve me mediat, në të cilat njih një partner të rëndësishëm për promovimin e aktiviteteve dhe instrumenteve të tij. Përveç praktikës së vendosur të rregullt të dërgimit të njoftimeve për shtyp mbi instrumentet e mbështetjes financiare dhe aktivitetet e Fondit, Njësia e marrëdhënieve me publikun do të vazhdojë të mbajë informime dhe konsultime të herëpashershme me përfaqësues të mediave dhe gazetarëve, gjë që ka provuar të jetë një praktikë e mirë në vitin e kaluar.

FIZHT këtë vit ndryshoi pamjen dhe redaktimin e faqes zyrtare të internetit në mënyrë që ta bëjë atë më të arritshme për qytetarët dhe përdoruesit, dhe të ofrojë kërkim më të lehtë interaktiv të të dhënave. Përveç gjuhës maqedonase, faqja e internetit gjithashtu ofron një version në gjuhën shqipe dhe angleze. Faqja e internetit vazhdimisht publikon informacione, dhe raporton për të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet që lidhen me punën e Fondit, si dhe rinovimin e përmbajtjes që lidhet me rregulloren.

Fondi gjithashtu do të vazhdojë të punojë në zhvillimin e një qasjeje të re në praninë e mediave sociale (Facebook, Twitter dhe Instagram) në mënyrë që të rrisë ndërveprimin dhe ofertën multimediale të informacionit.

Me qëllim të modernizimit të mënyrës së informimit të publikut për aktivitetet e FIZHT-it, gjatë vitit 2023 është planifikuar të blihen 4 (katër) tabela smartboard, 2 (dy) për ambientet e FIZHT-it në Shkup, nga 1 (një) për Info-Qendrat e planifikuara në Manastir dhe Tetovë.

Në pajtim me programin vjetor dhe trendet globale në fushën e inovacionit, Fondi i Inovacioneve do të organizojë ose koordinojë ngjarje biznesi, seminare dhe punëtori gjatë gjithë vitit në mënyrë që të transformojë startap ekosistemin e Maqedonisë, por edhe të aplikojë teknologji dhe praktika të reja në sektorin privat të Maqedonisë.

Në vitin 2023, Fondi planifikon të vazhdojë të zhvillojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe vendore, institucionet, fakultetet, ambasadat, për të zbatuar projekte të përbashkëta me karakter kërkimor, zhvillimor dhe shkencor; aktivitete të përbashkëta arsimore dhe promovuese; zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit; asistencën e ekspertëve dhe analizën e projekteve dhe sipërmarrjeve specifike, shkëmbimin e ndërsjellë të informacioneve, njohurive dhe përvojave në fusha me interes të përbashkët, si dhe pjesëmarrjen, bashkëpunimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta.

Për të informuar publikun dhe për të inkurajuar të gjithë ata që po mendojnë të fillojnë biznesin e tyre, ose të aplikojnë për mbështetje financiare, Fondi do të vazhdojë të bëjë fushata promovuese në të cilat do të paraqiten historitë (projektet) e suksesit të përdoruesve ekzistues.

Me qëllim të realizimit të qëllimeve në fushën e marketingut, marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit me publikun, FIZHT, përveç kapaciteteve ekzistuese brenda Fondit, do të angazhojë një agjenci profesionale, nëpërmjet së cilës do të komunikojë në mënyrë më të mirë vlerat, politikat dhe qëllimet e saj për publikun.

MBIKËQYRJA DHE VLERËSIMI (monitorimi i përdoruesve)

Në vitin 2023, në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në rregulloret e instrumenteve mbështetëse, është paraparë të vazhdohet me ndjekjen e ecurisë së projekteve në drejtim të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara, dhe realizimit të kostove të parashikuara

në pajtim me buxhetin e miratuar të projektit, si dhe ndjekjen e rezultateve të arritura pas përfundimit të projektit nëpërmjet dorëzimit të raporteve semestrale dhe vjetore.

Zbatimi i projekteve nga përdoruesit monitorohet nëpërmjet raporteve tremujore dhe përfundimtare, narrative dhe financiare të dorëzuara, si dhe nëpërmjet realizimit të vizitave në terren të paktën një herë në vit. Duke pasur parasysh numrin e madh të përdoruesve ekzistues, është planifikuar të ruhet praktika e angazhimit të firmave të jashtme të revizionit (të përzgjedhura me tender), që marrin pjesë në procesin e monitorimit dhe ndjekjes së përdoruesve të fondeve në pajtim me rregullat dhe procedurat e FIZHT-it.

## **PUNË TË PËRGJITHSHME, JURIDIKE DHE FINANCIARE**

### **UDHËHEQJA**

**Në kuadër të punës së Këshillit drejtues për vitin 2023, është planifikuar të miratohen:**

- Programi vjetor i punës për vitin 2023,
- Plani vjetor financiar i Fondit për vitin 2023,
- Plani i prokurimit publik për vitin 2023,
- Raporti vjetor për punën e Fondit për vitin 2022,
- Llogaria vjetore për vitin 2022,
- Raporti vjetor i revizionit për vitin 2022,
- Rregullore për instrumentet e reja.

**si dhe miratimin e dokumenteve të tjera ose marrjen e vendimeve për punë të tjera sipas Ligjit, Statutit dhe akteve të përgjithshme të Fondit.**


**Këshilli drejtues, edhe këtë vit do të vazhdojë të ndjekë në mënyrë aktive zbatimin e programeve dhe funksionimin e rregullt të Fondit.**

**Komiteti i Miratimit të Investimeve** (në tekstin e mëtejme Komiteti) gjatë gjithë vitit 2023 do të punojë në vlerësimin dhe zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së propozimprojekteve të planifikuara në Programin vjetor për vitin 2023, sipas Ligjit të Veprimtarisë Inovative dhe aktet nënligjore të Fondit.

**Përveç kësaj, është planifikuar që Komiteti të vendosë për kërkesat nga përdoruesit për ndryshime më të rëndësishme në projektet aktuale, ndryshimet në strukturën e pronësisë, kërkesat për zgjatjen e afateve për zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të tjera që janë në kompetencë të Komitetit.**

## **STRUKTURA ORGANIZATIVE**

**Struktura organizative ekzistuese e Fondit është si më poshtë:**



**Si rezultat i rritjes së aktiviteteve të Fondit dhe pozicionimit të Fondit si një institucion udhëheqës për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, është planifikuar të ndërmerren aktivitete me qëllim të fillimit të ndryshimeve në strukturën organizative të Fondit, për forcimin e kapitalit njerëzor të Fondit, dhe rregullimin e organizimit ekzistues të aktiviteteve të përgjithshme të zbatuara në Fond.**

**Edhe në këtë vit kalendarik, punonjësit e Fondit do të përmirësohen nëpërmjet trajnimeve, vizitave studimore në institucione të ngjashme jashtë vendit, seminareve, konferencave, grupeve të punës, punëtorive, kurseve të ndryshme.**

**Kapaciteti institucional i Fondit do të ndërtohet edhe nëpërmjet përdorimit të ndihmës teknike nga partnerët vendas dhe të huaj, si dhe nëpërmjet angazhimit të konsulentëve në Fond, për tema që lidhen me nevojat aktuale të Fondit.**

**FIZHT, në pajtim me legjislacionin, do të fillojë procesin e formimit të një Qendre Kërkimore brenda FIZHT-it, qëllimi kryesor i së cilës do të jetë të kryejë kërkime në fushën e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik. Është planifikuar që profesorë dhe shkencëtarë të shquar nga fushat me interes për punën e FIZH-së të angazhohen në Qendrën Kërkimore.**

## PROCESET E TJERA

Për operacionet që realizohen në Fond, do të mbahen sisteme adekuate dhe procese të përshkruara. Do të mirëmbahet sistemi i menaxhimit të bazës së të dhënave për përdoruesit e instrumenteve nga Fondi, dhe të sistemeve të tjera në pajtim me rekomandimet e Bankës Botërore.

Në periudhën e ardhshme trevjeçare, parashikohet ndërtimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve operative të Fondit, ndër të tjera, për menaxhimin mjedisor, ekspertizën ligjore në transaksionet financiare, vlerësimin e pronësisë intelektuale dhe menaxhimin e pronësisë intelektuale, si dhe ndjekjen e rezultateve dhe vlerësimit mbi ndikimin e instrumenteve financiare.

- Vlerësimi i ekspertëve të angazhuar nga FIZHT

**Në zbatim të nenit 25-a të Ligjit të Veprimtarsë Inovative, nenit 7 të Rregullores për mënyrën e përfshirjes së ekspertëve në punën e Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik dhe Udhëzimit për mënyrën e vlerësimit të personave profesionalë në vitin 2023, do të fillojë procedura për vlerësimin e ekspertëve në punën e Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik. FIZHT planifikon të punësojë një agjenci, shtëpi konsulente të specializuar që do të kryejë procesin e vlerësimit të personave profesional. Pasi të përfundojë ky proces, FIZHT do të përditësojë Regjistrin e Personave Profesional.**

- Sistemi i Plagjiaturës

**Gjatë vitit 2023, FIZHT planifikon të sigurojë një sistem plagjiature, me qëllim të verifikimit më të mirë dhe më të besueshëm të origjinalitetit të projekteve të aplikuesve, veçanërisht në segmentin e inovacionit të tyre.**

## DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

**Ky program vjetor hyn në fuqi në ditën e shpalljes në tabelën e shpalljes së Fondit, dhe do të shpallet pas marrjes së pajtimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.**



\_\_\_\_\_.2023, Shkup

të Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit  
Teknologjik

**Monika Jovanova**



